

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5646
E enjte, 6 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

I jepet lamtumira e fundit presidentit George H.W. Bush



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

PËRFUNDON INTERVISTIMI I DËSHMITARËVE PËR RASTIN E DËBIMIT TË SHTETASVE TURO

F. 3

TAHIRI U SHKRUAN LETËR HAHNIT DHE AVRAMOPOULOSIT PËR SHTYRJEN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

F. 3

KËRCËNOHET KRYETARI I KLLOKOTIT

F. 10

EKONOMI

MEHMETI: SEKTORI BANKAR, KONTRIBUES NË RRITJEN EKONOMIKE TË VENDIT

F. 8

NIS IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT QË NDIHMON BIZNESET TË EKSPORTOJNË NË TREGJET E HUAJA

F. 8



KULTURË

MINISTRI GASHI: KOSOVA ÇDO DITË E MË SHUMË POKË MBRON AUTORITETIN

F. 13

SPORT


SEZON FANTASTIK PËR DRENICËN DHE YMERIN

F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAJ

IFAQE 4-5

BE-ja shpërfilli Kosovën me mosliberalizim të vizave



Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se shtyrja e liberalizimit të vizave më shumë ka të bëjë me rrethanat politike të Bashkimit Evropian (BE) sesa me Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se BE-ja nuk i ka përmbushur premtimet

si dhe ka shpërfillur Kosovën duke mos i liberalizuar vizat. Megjithatë, Hoxhaj ka thënë se institucionet e Kosovës duhet ta vazhdojnë betejën që çështjen e vizave ta vendosin në agjendën e radhës të Këshillit të Ministrave të BE-së. Ai ka theksuar se përderisa deputetët e

Parlamentit Evropian thonë se Kosova i ka përmbushur kriteret, vlerësimet në Prishtinë janë të paarsyeshme dhe kanë të bëjnë me luftën për pushtet e cila, sipas Hoxhaj, sidomos në procesin e liberalizimit të vizave, nuk i bën nder askujt

NATO-ja tërheq vërejtjen për ushtrinë, Kosova e vendosur ta vazhdojë këtë proces

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka paralajmëruar të mërkurën Kosovën se do të "përballet me pasojë serioze nëse vazhdon transformimin e FSK-së në ushtri". Sipas tij, ky proces po udhëhiqet "në një çast mjaft të papërshtatshëm, pa u respektuar procedurat". Zyrarët e Qeverisë së Kosovës i janë kundërpërgjigjur paralajmërimit të Stoltenbergut, duke thënë se transformimi



i FSK-së është në përputhje me angazhimet bilaterale dhe multilaterale të Kosovës me shtetet anëtare të NATO-s

IFAQE 3



Kërkohet mobilizim i institucioneve përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë

IFAQE 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

I jepet lamtumira e fundit presidentit George H.W. Bush

Shtetet e Bashkuara i dhanë lamtumirën të mërkurën ish-presidentit George H.W. Bush me një funeral shtetëror në Uashington, ku morën pjesë figura të larta të politikës amerikane, së bashku me udhëheqës aktualë e të mëparshëm nga e gjithë bota



UASHINGTON, 5 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara i dhanë lamtumirën të mërkurën ish-presidentit George H.W. Bush me një funeral shtetëror në Uashington, ku morën pjesë figura të larta të politikës amerikane, së bashku me udhëheqës aktualë e të mëparshëm nga e gjithë bota. Ish-presidentët amerikanë Jimmy Carter, Bill Clinton dhe Barack Obama iu bashkuan presidentit Donald Trump, gjatë shërbimit të përmortshëm për ish-presidentin George H.W. Bush në Katedralen Kombëtare të Uashingtonit, ku fjalimi kryesor u mbajt nga George W. Bush, djali i presidentit të ndjerë si dhe presidenti i 43-të i SHBA-së. "Ai na mësoi se shërbimi publik ishte diçka fisnike dhe e domosdoshme", tha ish-presidenti Bush përpara të pranishmëve në katedralen shpirtërore episkopale. "Ai kishte një aftësi të madhe për të dhënë nga vetvetja", tha ai. Ndërsa mbaronte fjalimin George W. Bush nisi të qajë. Ai e përshkroi babanë e tij si "një njeri të madh e fisnik". Presidenti Trump nuk mbajti fjalim gjatë funeralit, por më herët në një postim në Twitter shkruante: "Ky nuk është një

funeral, kjo është një ditë kremtimi për një njeri të madh që ka pasur një jetë të gjatë e të shquar. Do të na mungojë!" Kancelarja gjermane Angela Merkel, Princi Charles i Britanisë, Mbreti Abdullah i Jordanisë dhe presidenti polak Andrzej Duda ishin mes atyre që ndoqën funeralin për nder të presidentit të 41-të të SHBA, i cili vdiq në moshën 94-vjeçare. Gjatë shërbesës u mbajtën fjalime edhe nga ish-kryeministri kanadez Brian Mulroney, ish-senatori amerikan Alan Simpson dhe historiani Jon Meacham, biograf i Bushit. Mulroney, udhëheqësi kanadez në kohën kur George H.W. Bush ishte në Shtëpinë e Bardhë prej vitit 1989 deri në 1993, tha se në historinë e Shteteve të Bashkuara ai nuk besonte kurrë se do të kishte një president "më të guximshëm, më parimor apo më të nderuar se George Herbert Walker Bush". Simpson rikujtoi miqësinë e tij të gjatë me ish-presidentin e ndjerë dhe tha: "Ai ishte një person i jashtëzakonshëm nga lindja deri në vdekje ... një nga njerëzit më fisnikë të kësaj toke". Meacham vlerësoi ish-presidentin Bush si "burrë shteti,

ushtari i fundit i jashtëzakonshëm i Amerikës". Ai tha se jeta e tij ishte një mision për të provuar vlerën e saj që nga koha kur ai ishte një pilot luftarak 20-vjeçar dhe i vetmi mes anëtarëve të tij të ekuipazhit që shmangu kapjen nga japonezët apo vdekjen gjatë Luftës së Dytë Botërore gjatë bombardimit që ndodhi në Paqësor në 1944. Që nga vdekja e tij, ish-presidenti Bush po përkujtohet për heroizmin e tij si një pilot i marinës, rolin udhëheqës në skenën botërore kur Bashkimi Sovjetik u shemb dhe Gjermania Lindore dhe Perëndimorë u ribashkuan në fillim të viteve 1990 sikurse dhe për mirësjelljen e dashamirësinë e tij si në jetën personale ashtu edhe atë publike.

Para funeralit shtetëror në Katedralen Kombëtare të Washingtonit të mërkurën, trupi i Presidentit George H.W. Bush u mbajt për homazhe në Hollin e Kapitolit. Vizitorët e shumtë qëndruan në radhë të gjata, për t'i bërë nderimet e fundit ish-udhëheqësit amerikan, që e kanë karakterizuar si një njeri të qetë, por njëkohësisht me karakter të fortë dhe të guximshëm. "Jam nga Teksasi, edhe presidenti ishte nga Teksasi, një njeri shumë i respektuar. Ka bërë gjëra shumë të mira për vendin", tha një qytetar nga Teksasi. Një vizitor nga Çikago thotë se media nuk u soll mirë me të kur ishte president. "Do të na mungojë ky njeri, për

civilizimin e tij. Tani shtypi po thotë: ishte njeri i shkëlqyer, por jo kur ai ishte president. Në atë kohë nuk u tregua i drejtë me të", tha ai. Ky vizitor nga shteti veriperëndimor i Meinit, ka qenë ushtarak, tani është në pension. "Ai është një hero i luftës, një president i shkëlqyer. Unë kam shërbyer në administratën e të birit, prandaj ndihem mirë që ndodhem këtu", tha ai. Një vizitor nga Marilendi thotë se ka qenë nxënës në shkollën e mesme kur Bushi ishte president. "Bushi ishte njëri prej presidentëve të fundit të moderuar republikanë". Tha ai. Mijëra njerëz bënë homazhe këto ditë në Rotundën e Kapitolit, në mesin e tyre pati politikanë dhe heronj të luftës sikurse presidenti Bush. Në mesin e tyre ishte edhe senatori Bob Dole, i cili erdhi me karrige me rrota për të nderuar ish-rivalin e tij në garën për të emëruarin presidencial të Partisë Republikane. Për t'i dhënë lamtumirën ish-presidentit, kishin sjellë edhe qenin e tij, Sully. Presidenti Donald Trump dhe Zonja e Parë Melania bënë homazhe për Bushin të hënë në mbrëmje. Trumpi mori pjesë gjithashtu në shërbesën te Katedralja Kombëtare.

Presidenti Thaçi në varrimin e ish-presidentit George H. W. Bush

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, po qëndron në ShBA, për të marrë pjesë në ceremoninë mortore dhe në varrimin e presidentit të 41-të të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George H. W. Bush. Në shenjë respekti shtetëror dhe qytetar për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës të presidentit të 41-të të ShBA-së, George H. W. Bush, presidenti Thaçi e ka shpallur ditën e mërkurë ditë zie shtetërore në Republikën e Kosovës. Flamujt u ulën në gjysmështizë, derisa në shkollat e Kosovës, në orën e parë të mësimit, u fol për miqësinë mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Kryeparlamentari Veseli udhëtoi për vizitë zyrtare në ShBA

Prishtinë, 5 dhjetor - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka udhëtuar për vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) gjatë së cilës do të zhvillojë takime me zyrtarë të lartë të

shtetit amerikan, Qeverisë dhe Kongresit. Në këto takime në Uashington dhe në Nju Jork, do të diskutohet për bashkëpunimin dhe miqësinë midis dy vendeve dhe popujve, si dhe për vazhdimin e

mbështetjes së ShBA-së për Kosovën në të gjitha fushat. Po ashtu, Veseli do të qëndrojë edhe në shtetin e Iowa-s. Në këtë shtet, kreu i Kuvendit të Kosovës do të ketë takime me përfaqësues politikë dhe

drejtues ushtarakë, në të cilat do të flitet për forcimin e bashkëpunimit në sferën ushtarake, në rethanat e reja kur pritet transformimi i FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës.



Është mbajtur takimi i ministrave të jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s në Bruksel

NATO-ja tërheq vërejtjen për ushtrinë, Kosova e vendosur ta vazhdojë këtë proces

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e ka paralajmëruar të mërkurën Kosovën se do të "përballet me pasoja serioze nëse vazhdon transformimin e FSK-së në ushtri". Sipas tij, ky proces po udhëhiqet "në një çast mjaft të papërshtatshëm, pa u respektuar procedurat". Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës i janë kundërpërgjigjur paralajmërimit të Stoltenbergut, duke thënë se transformimi i FSK-së është në përputhje me angazhimet bilaterale dhe multilaterale të Kosovës me shtetet anëtare të NATO-s

EPOKA E RE**Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Një javë para se Kosova ta votojë në Kuvend transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka paralajmëruar Kosovën se mund të përballet me pasoja nëse vazhdon transformimin e FSK-së në ushtri. Pas takimit të Ministrave të Jashtëm të NATO-s në Bruksel, Stoltenbergu ka thënë se ky proces po udhëhiqet "në një moment mjaft të papërshtatshëm, pa u respektuar procedurat". "Ne diskutuam për qëllimin e Kosovës për të ecur përpara me transformimin e forcave kosovare të sigurisë në ushtri. Një veprim i tillë është në kohë të gabuar. Kjo shkon në kundërshtim me këshillat e shumë aleatëve nga NATO-ja. Dhe kjo mund të ketë pasoja serioze për të ardhmen e integriteteve euroatlantike të Kosovës", ka thënë Stoltenbergu.

Paralajmërimit të të shefit të NATO-s i janë përgjigjur zyrtarët e lartë të Qeverisë së Kosovës.

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Burim Ramadani, ka thënë se transformimi i FSK-së është në përputhje me angazhimet bilaterale dhe multilaterale të Kosovës me shtetet anëtare të

NATO-s, sikurse edhe me Selinë Qendrore të NATO-s. "Nuk ka vend fare për konfuzion. Tranzicioni i FSK-së është në përputhje me angazhimet bilaterale dhe multilaterale të Kosovës me shtetet anëtare të NATO-s, sikurse edhe me Selinë Qendrore të NATO-s. Duhet t'i kuptojmë vështirësitë e NATO-s për konsensus për shkak të shteteve jonjohëse aty. Ne, fatkeqësisht, nuk kemi pasur qasje direkte në kryeqytetet e disa prej këtyre shteteve jonjohëse për t'ia shpjeguar procesin dhe planin e Kosovës", ka shkruar Ramadani në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka vlerësuar se Kosova e mirëpret thellimin e angazhimit të NATO-s në Kosovë përmes NALT-it dhe Bashkëveprimit të Zgjeruar. Sipas tij, KFOR-i po ashtu do të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë dhe do të thellohet bashkëpunimi. "Tranzicioni i FSK-së është proces legjitim dhe gradual. Pas miratimit të ligjeve, FSK-ja do të ketë tranzicion dhjetëvjeçar për t'i përmbushur kapacitetet e plota operacionale. Kosova synon të jetë anëtare e NATO-s, u takon këtyre vlerave dhe do t'i thellojë përpjekjet për këtë qëllim kombëtar. Kosova dhe FSK-ja janë të gatshme që krah për krah me ushtritë e shteteve anëtare të NATO-s ta ndihmojnë paqen, sigurinë dhe sta-



bilitetin në rajone të ndryshme nëpër botë", është shprehur Ramadani.

Paralajmërimi i votimit të ushtrisë më 14 dhjetor ka nxitur reagime të zyrtarëve në Beograd, të cilët thonë se "formimi i ushtrisë së Kosovës mund ta rrezikojë paqen e qëndrueshmërinë dhe mund të çojë në pasoja tragjike". Zyrtarët serbë kanë ngritur shqetësimin që autoritetet e Prishtinës do ta përdorin ushtrinë e ardhshme kundër qytetarëve serbë në Kosovë.

Kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka thënë të mërkurën se shpreson që Serbia nuk do të ketë nevojë ta përdorë ushtrinë e vet, pas themelimit të ushtrisë së Kosovës. "Shpresoj se nuk do të kemi kurrë nevojë ta përdorim ushtrinë por, në këtë moment, një gjë e tillë është një nga mundësitë në tryezë, sepse nuk mund të shohim pastrim të ri etnik dhe stuhi të reja, edhe pse [kryeministri i Shqipërisë] Edi Rama bën thirrje për të tilla", ka

thënë ajo në një takim me gazetarë në Qeverinë e Serbisë, por pa e saktësuar se për çfarë komentesh të kryeministrit Rama bëhet fjalë.

Por, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të mërkurën se krijimi i ushtrisë nuk po bëhet për t'i shqetësuar banorët serbë në veri të Kosovës, por për t'i ndihmuar forcat e NATO-s në luftërat aktuale. "Së pari ne nuk e kemi ushtrinë për veriun e Kosovës. Ne ushtrinë e kemi për Afganistan dhe Irak për ta ndihmuar NATO-n. Pra, nuk kemi plane për veri. I ftoj serbët e Kosovës të shërbejnë në Forcën e Sigurisë që do të quhet edhe më tutje. Asnjë plan për destabilizim as të veriut e as të një zone tjetër. Kosova është shtëpia e të gjithë neve dhe banorët në veri janë në shtëpinë e tyre. Edhe ata në jug dhe ne kudo që jemi. Kosova nuk ka qëllim t'i shqetësojë banorët serbë", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ndërkaq ministri i Ministrisë

për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e ri të KFOR-it në Kosovë, gjeneralin Frances Lorenzo D'Addario, të cilin e ka falënderuar për ndihmën e vazhdueshme për FSK-në si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes të FSK-së dhe KFOR-it. Ministri i FSK-së ka deklaruar se kjo forcë do ta vazhdojë bashkëpunimin me KFOR-in. Kuvendi i Kosovës ka vendosur që më 14 dhjetor t'i votojë në lexim të dytë tri projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në leximin të parë kjo pako e projektligjeve kishte marrë mbështetje të fuqishme parlamentare, duke u votuar nga të gjitha partitë parlamentare, përveç Listës Serbe, e cili nuk kishte marrë pjesë në seancë. Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes kishte marrë 101 vota, ai për Forcën e Sigurisë së Kosovës 98, kurse Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës 96 vota.

Përfundon intervistimi i dëshmitarëve për rastin e dëbimit të shtetasve turq



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Të mërkurën ka përfunduar intervistimi i dëshmitarëve për rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars të këtij viti. Kështu ka bërë me dije deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj.

Ai në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ka qenë një proces shumë i mundimshëm dhe me plot

ngatërresa në vendimarrje dhe në zbatim. "Komisioni hetimor parlamentar, pjesë e të cilit jam edhe unë, ka për detyrë ta përpilojë raportin me shkeljet që janë bërë, që kjo të na shërbejë që Kosova kurrë më të mos e bëjë edhe një tjetër gabim si ky. Krejt çfarë na duhet në këtë moment është ta përpilojmë një raport faktografik e jo politik", ka thënë

deputeti Nitaj.

Kryeministri Ramush Haradinaj në raportimin e tij para Komisionit Hetimor Parlamentar ka thënë se dëbimi i shtetasve turq ka qenë një mënyrë e nxituar pasi, sipas tij, ka mundur të shkojë ndryshe nëpër etapa që i parashihet ligji. Kryeministri ka pranuar se për këtë dëbim të shtetasve turq nuk ka qenë i informuar.

Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

BE-ja shpërfilli Kosovën me



Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se shtyrja e liberalizimit të vizave më shumë ka të bëjë me rrethanat politike të Bashkimit Evropian (BE) sesa me Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se BE-ja nuk i ka përmbushur premtimet si dhe ka shpërfillur Kosovën duke mos i liberalizuar vizat. Megjithatë, Hoxhaj ka thënë se institucionet e Kosovës duhet ta vazhdojnë betejën që çështjen e vizave ta vendosin në agjendën e radhës të Këshillit të Ministrave të BE-së. Ai ka theksuar se përderisa deputetët e Parlamentit Evropian thonë se Kosova i ka përmbushur kriteret, vlerësimet në Prishtinë janë të paarsyeshme dhe kanë të bëjnë me luftën për pushtet e cila, sipas Hoxhaj, sidomos në procesin e liberalizimit të vizave, nuk i bën nder askujt

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 5 DHJETOR -
"Epoka e re": Z. Hoxhaj, ju dhe zyrtarët e tjerë shtetërorë në vazhdimësi keni shprehur optimizëm se brenda këtij viti do të ndodhë liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, por një gjë e tillë nuk u realizua. Pse Kosovës nuk iu hoqën vizat?
Hoxhaj: Kjo pyetje e ka përgjigjen në Bruksel. Përgjigja jonë është se janë plotësuar të gjitha

kriteret, nga kriteri i parë deri në kriterin e 95-të. Ka pasur shumë zyrtarë të Bashkimit Evropian të cilët kanë deklaruar se nëse Kosova i plotëson dy kriteret e fundit do të shpërblehet në këtë proces. Në vitin 2016 kemi pasur një raport të vlerësimit pozitiv pa dy kriteret e fundit dhe në vitin 2018 Komisioni Evropian ka dalë me një vlerësim pozitiv se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe Parlamenti Evropian mund ta votojë këtë rekomandim. Një

votë e tillë ka ndodhur. Tash përgjigja është në Bruksel dhe më shumë ka të bëjë me rrethanat politike të vet BE-së sesa me Kosovën. Por, natyrisht se një vendim i tillë nuk është asgjë tjetër veçse shpërfillje e Kosovës dhe mospërmbushje e premtimeve të BE-së.

"Epoka e re": Pra, BE-ja është fajtorë për dështimin e liberalizimit të vizave?

Hoxhaj: Isha shumë i qartë në atë që thashë. Është mospërmbushje

e premtimeve dhe shpërfillje e Kosovës. Ndërsa neve na mbetet të shohim se a do të mund të vendoset në agjendën e radhës të Këshillit të Ministrave të BE-së. Kjo është beteja që duhet ta vazhdojnë institucionet e Kosovës. Qytetarëve të Kosovës u takon që ta gëzojnë një të drejtë të tillë. Çfarë do të duhej të bënte Kosova, e ka bërë. Procesi ka qenë teknik dhe ne kemi pritur që në fund të këtij procesi të kemi një vendimarrje politike, mirëpo ne flasim në emër të Kosovës, por nuk mund të flasim në emër të Bashkimit Evropian.

"Epoka e re": Opozita po e bën përgjegjëse Qeverinë për dështimin e liberalizimit të vizave, madje me kërkesë të saj të martën është mbajtur një seancë e jashtëzakonshme, ku është kërkuar llogari për këtë çështje, duke iniciuar edhe miratimin e një rezolute. Si i komentoni këto reagime dhe a

duhet të votohet kjo rezolutë?

Hoxhaj: Procesi i përmbushjes së kriterëve duhet të shihet në tërësi. Kanë qenë disa Qeveri dhe disa parti politike që kanë dhënë kontributin e tyre. Përtej punës që kemi për të qenë në shërbim të qytetarëve, qeveria aktuale e ka dhënë maksimumin që vërtet të përmbushen të gjitha kriteret. Nëse deputetët e Parlamentit Evropian dalin dhe thonë si dhe i shkruajnë letër Këshillit të Ministrave të BE-së dhe presidencës austriake të BE-së se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret, ma merr mendja se çdo vlerësim në Prishtinë është i paarsyeshëm dhe është më shumë pjesë e luftës për pushtet e cila, sidomos në procesin e liberalizimit të vizave, nuk i bën nder askujt.

"Epoka e re": Do ta votojnë deputetët e PDK-së këtë rezolutë?

Hoxhaj: Absolut jo.

mosliberalizim të vizave

aspekt duhet të jemi të gjithë në një qëndrim se e kemi kryer punën, por BE-ja nuk i ka njohur këto merita. Tash e tutje na mbetet të vazhdojmë dhe të bëjmë përpjekje që ta krijojmë një momentum të ri në takimin e radhës të Këshillit të Ministrave të BE-së.

"Epoka e re": Komisionari Hahn gjatë qëndrimit në Prishtinë ka përmendur 2020 si vit optimal për heqjen e regjimit të vizave. Duke pasur parasysh zgjatjen e deritanishme të procesit, ka rrezik që vizat mos të hiqen deri atëherë?

Hoxhaj: Nuk dua të hyj në fushën e spekulimeve dhe nuk dua ta komentoj fare deklaratën e komisionarit Hahn. Ai fol në emër të BE-së, ne flasim në emër të Kosovës.

"Epoka e re": A duhet të shqyrtojë Kosova qasjen ndaj BE-së meqë kjo e fundit nuk i ka realizuar premtimet si dhe nuk e ka shpërblyer konstruktivitetin e Kosovës?

Hoxhaj: Nëse dikush e lexon drejt realitetin politik dhe vendimet që i kemi marrë në javët e fundit jemi më se të qartë. Ne këto qëndrime i kemi ndjekur në çdo takim. Unë kam qenë një prej atyre që ka qenë më i zëshmi prej korrikut dhe gushtit, se më është thënë në atë kohë se realisht edhe nëse vendos Parlamenti Evropian pozitivisht, shtetet anëtare kanë hezitimet e tyre. Nuk kemi lënë gurë pa lëvizur që kjo çështje të mbyllet suksesshëm, nuk ka vendimmarrje në dhjetor, por do të shohim se kur do të mund të jetë vendimmarrja e radhës. Unë nuk kisha hyrë në një cikël të bartjes së përgjegjësive sa isha koncentruar se si ta bëjmë një kthesë dhe ta kemi një depërtim drejt një vendimmarrje pozitive.

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, si e shini vazhdimin e procesit të dialogut pas këtyre zhvillimeve të fundit, po shohim një qasje pak më afëruese të PSD-së, por jo edhe të LDK-së dhe LV-së për këtë proces?

Hoxhaj: E çmojmë shumë qasjen që e ka Partia Socialdemokrate (PSD) në raport me dialogun. Besoj se është sjellje dhe vetëdije shtetërore dhe në një seancë të radhës do të shohim se si mund të përafrohet qëndrimi i tyre me qëndrimin e partive të koalicionit qeverisës. Dialogu nuk është një temë që i takon vetëm Qeverisë, natyrisht se Qeveria ka rol dhe kompetenca në politikën e jashtme, por

dialogu, epilogu i dialogut, marrëveshja, dhe zbatimi i marrëveshjes kanë efekt afatgjatë për jetën tonë politike, prandaj këtu duhet ta shohin veten përgjegjës Qeveria dhe opozita. Një pjesë e opozitës e cila dëshiron që të ketë rol determinues në dialog është diçka që duhet të çmohet. Besoj se brenda dhjetorit mund të ketë ndonjë seancë ku mund të votohet ekipi i cili do të duhet që së bashku me presidentin Thaçi ta udhëheqë dialogun në një fazë të rëndësishme të përmbylljes së shtetndërtimit përmes njohjes së ndërsjellët dhe të kompletimit të sovranitetit nëpërmjet anëtarësimit të Kosovës në OKB.

"Epoka e re": A mendoni se Kosova më në fund mund do ta arrijë unitetin politik për procesin e dialogut me Serbinë?
Hoxhaj: Është një momentum i

ri. Të shohim tash se si ky momentum i ri i cili reflekton vullnetin e partive politike mund të jetësohet në Kuvendin e Kosovës përmes një rezolute, një ekipi dhe një platforme në të ardhmen se si Kosova të hyjë në një qartësi strategjike. Por, një gjë qëndron, se dialogu duhet të shihet prioritet prej çdokujt në Kosovë, ndërsa PDK-ja si parti tradicionale do ta japë maksimumin që ta nxjerrë më të mirën e mundshme për Kosovën në këtë proces. Është një temë jopopullore dhe mund të flitet për ngecjet që ka pasur Kosova në dialog, për marrëveshjet e nënshkruara, për marrëveshjet e pazbatuara, për lojën dyfytërshe që po e bën Serbia në raport me Kosovën. Është jetike që të tregojmë një pjekuri politike dhe vetëdije shtetërore dhe sa t'i ruajmë arrijtet që i ka pasur Kosova në

dhjetë vjet e fundit, po aq edhe ta lëvizim vendin drejt një fazë të re.

"Epoka e re": Është shtuar presioni ndaj Qeverisë për heqjen e taksës ndaj produkteve serbe, por jo edhe ndaj Serbisë e cila nuk po lë gurë pa lëvizur për ta goditur Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Hoxhaj: Qëndrimi i Qeverisë së Kosovës është i qartë: taksa mbetet në fuqi. Duhet fillimisht të shikohen arsyet dhe shkaqet se si kemi ardhur deri te taksa, mandej si Qeveri kemi vullnet dhe fleksibilitet që ta rregullojmë një gjë të tillë. Por, përderisa Serbia e godet Kosovën ndërkombëtarisht, e cenon dhe e lëndon sovranitetin tonë të jashtëm, ne si vend kemi qenë të detyruar të sillemi në këtë formë. Kjo është qasja jonë.

Miratohet projektligji për mësimdhënësit e viteve të '90-ta

PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e së mërkurës, të kryesuar nga Lumir Abdixhiku, kryetar, ka shqyrtuar një mori projektligjesh. Ky komision ka miratuar Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99. Po ashtu, ka ratifikuar edhe marrëveshjen për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria Ag, për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës. Projektligjin për ratifikimin e

marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës, si dhe Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar (i cili në këtë mbledhje është shqyrtuar në parim), i paraqiti dhe arsyetoi ministri i Ministrisë së Financave, Bedri Hamza. Pas kësaj, ky komision ka miratuar edhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamenteve

të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Raportin me rekomandime të grupit punues të komisionit, lidhur me Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale, si dhe Raportin me rekomandime të grupit punues të komisionit lidhur me Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave. Në fund të kësaj mbledhjeje përfaqësues të GIZ-it para komisionit shpalesën një analizë të bërë prej tyre, e që kishte të bënte me Projektligjin e buxhetit për vitin 2019.



"Epoka e re": Një pjesë të përgjegjësive për dështimin e liberalizimit të vizave e ka edhe opozita?

Hoxhaj: Debatimi në Kosovë, se kush është përgjegjës për liberalizimin e vizave, është i pavend, nuk përkon me realitetin, është i padrejtë dhe flet më shumë për kulturën dhe pjekurinë tonë politike të cilën nuk ia kisha dashur këtij vendi. Kosova e ka bërë atë që është dashur ta bëjë. Vendimmarrja në Bashkimin Evropian është e institucioneve të BE-së, por edhe e shteteve anëtare. Disa shtete anëtare haptas kanë dalë kundër procesit të liberalizimit të vizave që për mua ka qenë absurde, sepse jemi duke folur për një grusht njerëzish të cilët edhe më tutje janë të izoluar dhe jemi duke folur për një proces teknik i cili duhet të përmbyllet me një vendimmarrje politike. Natyrisht se Qeveria e Kosovës mund të kritikohet për çdo gjë, por jo për liberalizim të vizave. Mendoj se në këtë

Opozita kushtëzon votën për buxhetin e vitit 2019

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Miratimi i buxhetit për vitin 2019 pritet të jetë një nga sfidat e radhës për Qeverinë e Kosovës ngaqë opozita nuk premtonte se do ta votojë projektligjin e propozuar për buxhetin. Shqyrtimi i parë i këtij projektligji është paraparë të paraqitet në seancën e Kuvendit të Kosovës më 6 dhjetor. Por, deputetët e partive opozitare nuk japin shumë shpresë se do të votojnë për miratimin në parim të buxhetit.

Subjekti më i madh opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thotë se nuk do të votojë projektbuxhetin, kurse Lëvizja Vetëvendosje thotë se nëse nuk përmirësohen disa nga mangësitë buxhetore, nuk do ta mbështesë në formën aktuale të propozuar. Ndërsa tjetër opozitar, Partia Socialdemokrate, nuk ka dhënë ndonjë përgjigje për këtë çështje.

Naser Osmani, deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, njëherësh anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, thotë se nuk do ta votojë buxhetin pasi, sipas tij, projektbuxheti për vitin e ardhshëm nuk është projektuar në mënyrë të duhur, është ngarkuar me skema sociale dhe është i ndarë në baza rajonale. "Lidhja Demokratike nuk e mbështet një buxhet të tillë, sidomos një buxhet që është bërë me ndarje buxhetore të lokaliteteve prej nga vijnë zyrtarët e Qeverisë. Ka shumë pak projekte në investime kapitale në komunat ku udhëheq LDK-ja. Dhe kjo vërehet në shpërndarjen jo të drejtë që është bërë dhe me këtë shpërndarje ata e kanë prishur edhe formulën e granteve, e cila është një formulë që shpërndahet në mënyrë proporcionale në bazë të disa kriterëve", tha Osmani, duke



shtuar se këto janë arsyt pse LDK-ja nuk mund të votojë, "sidomos duke u frikësuar se rrezikohet rregulla financiare që konsiderojmë se është rregull që mos të tejkalohet deficitin deri në 2 për qind i Bruto Produktit Vendor që është i definuar në bazë ligjore", thotë Osmani.

Ndërkaq Arbërie Nagavci, deputete në Kuvendin e Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje, po ashtu anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha për Radion Evropa e Lirë se projektbuxheti për vitin e ardhshëm nuk është buxhet i konsoliduar, transparent dhe as në shërbim të qytetarëve.

Ky projektbuxhet, sipas saj, akomodon lukse të shumta, dallime në paga të shërbyesve civilë, pavarësisht prej koeficientit të

tyre dhe rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Nëse nuk përmirësohen mangësitë e evidentuara nga Lëvizja Vetëvendosje, Nagavci thotë se nuk do të votojë për projektligjin. "Ne kemi parë se në agjenci të caktuara është dhjetëfishuar buxheti, qoftë për zyre të kryeministrit apo të presidentit. Në anën tjetër nuk janë adresuar as qëndrimet që i ka pasur Qeveria në programin qeverisës për prioritetet e veta. Nëse shohin në fushën e arsimit, ndonëse po proklamohet rritje e buxhetit, nuk ka investime në infrastrukturë, asnjë çerdhe apo shkollë e re nuk është planifikuar të ndërtohet. Pra, kryesisht janë projekte të filluara shumë më herët dhe po zgjasin për një kohë të gjatë. Thjesht, janë paraqitje

për një mashtrim të votuesit për rajone të caktuara", shprehet Nagavci.

Në muajin tetor Qeveria e Kosovës ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2019 i cili parashihet ta arrijë shifrën e 2.3 miliardë eurove dhe i cili parasheh rritje të shumës për pagesën e skemave sociale. Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit të Financave në Qeverinë e Kosovës, për "Radion Evropa e Lirë" thotë se ky buxhet pritet të jetë më i larti që ka pasur ndonjëherë Kosova dhe konsiderohet të jetë i realizueshëm, i qëndrueshëm dhe që ruan stabilitetin fiskal. "Çështja e votimit është e drejtë e secilit deputet. Në buxhetin e kemi përgatitur në përputhje të objektivave të programit të Qeverisë së Kosovës.

Është një projektbuxhet i cili shkon në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit, ngre kualitetin ndaj shërbimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është një buxhet që në të gjitha kategoritë ka ngritje krahasuar me vitin e kaluar. Dhe duke pasur parasysh të gjithë këta faktorë pozitivë dhe një buxhet kaq mirë të ndërtuar, nuk presim që nuk do të votohet", tha Rafuna. Ndërsa nëse buxheti nuk votohet, sipas procedurave ligjore në Kuvendin e Kosovës, deri më 20 dhjetor vendi mund të shkojë në krizë buxhetore. Atëherë, sipas afatit kohor, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave, në tre muajt e parë të vitit të ardhshëm shpenzimet buxhetore duhet të realizohen në 1/12 e buxhetit të këtij viti.

Myftiu Tërnavë merr pjesë në forumin për promovimin e paqes në Abu Dhabi



PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe ka nisur punimet forumi i pestë për promovimin e paqes në shoqëritë islame. Në këtë forum po merr pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naimef. Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij. Ky forum do të zgjasë dy ditë, ku në mesin e personaliteteve fetare e shkencore do të ligjërojë edhe Myftiu Tërnavë. Ky është forumi i pestë për promovimin e paqes në shoqëritë islame dhe do të zgjasë deri më

7 dhjetor. Në këtë forum po marrin pjesë më shumë se 800 dijetarë dhe mendimtarë me ndikim në botë nga 120 vende, përfshirë këtu ministra të punëve fetare, myfti, përfaqësues nga komuniteti mysliman si dhe delegatë nga Kombet e Bashkuara dhe organizatat e të drejtave të njeriut në mbarë botën. Studiuesit dhe intelektualët do ta diskutojnë metodologjinë e krijimit të një aleance virtutesh për të arritur një diskurs botëror të miqësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, bazuar në vlerat dhe virtytet e përbashkëta.

Tahiri u shkruan letër Hahnit dhe Avramopoulosit për shtyrjen e liberalizimit të vizave

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka nisur të mërkurën një letër zyrtare te komisionari për Politikë të Fqinjësisë së Mirë dhe Negociatë të Zgjerimit, Johannes Hahn dhe komisionari për Çështje të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, për t'i njoftuar lidhur me aprovimin e legjislacionit tepër të rëndësishëm për reformimin e sektorit të drejtësisë dhe përmbushjes së obligimeve të dala nga procesi i liberalizimit të vizave.

Përmes kësaj letre ministri Tahiri ka theksuar se janë përmbushur të gjitha kërkesat e dala për liberalizimin e vizave dhe, po ashtu, që ndryshimet legjislative janë përmbushje e obligimeve të dala edhe nga plani vjetor i Qeverisë për vitin 2018, Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, Planit Zhvillimor Strategjik i Ministrisë së Drejtësisë 2018-2021 adresojnë gjetjet e raporteve të vendit të Komisionit Evropian për vitin 2016 dhe 2018. "Ministria e Drejtësisë është e përkushtuar ta vazhdojë përmbushjen e prioritetëve qeveritare dhe të 'iarrë masat e duhura për fuqizimin e sektorit të sundimit të ligjit dhe, po ashtu, për zbatimin e këtyre ligjeve edhe në praktikë. Për më shumë, Ministria e Drejtësisë do t'u japë përparësi politikave që synojnë promovimin dhe avancimin e efikasitetit dhe efektivitetit të punës së institucioneve të drejtësisë dhe

Nëpërmjet letrës drejtuar komisionarit për Politikë të Fqinjësisë së Mirë dhe Negociatë të Zgjerimit, Johannes Hahn dhe komisionarit për Çështje të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i ka njoftuar ata me aprovimin e legjislacionit tepër të rëndësishëm për reformimin e sektorit të drejtësisë dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga procesi i liberalizimit të vizave



fuqizimit të llogaridhënies" ka shkruar ministri Tahiri në letër. Duke parë rëndësinë që kanë reformat në drejtësi për liberalizimin e vizave, ministri Tahiri ka njoftuar komisionarët se më 23 nëntor Kuvendi ka miratuar Kodin Penal, Ligjin për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale, atë

për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligjin për Gjykatat, për Këshillin Gjyqësor, për Noterinë, Ligjin për Amendamentin dhe Plotësimin e Ligjit për Trashëgiminë si dhe Ligjin për Amendamentin

Plotësimin e Ligjit për Procedurën Jo-Kontestimore. "Ne besojmë në vazhdimin e bashkëpunimit konstruktiv dhe në marrjen e asistencës së nevojshme për t'i mbështetur edhe më tutje institucionet e drejtësisë, në mënyrë që vetë sistemi i drejtësisë në Kosovë të jetë funksional, efikas, pro-

fesional, i depolitizuar, i integruar dhe i shtrirë në gjithë territorin e vendit. Andaj, më lejoni ta shpreh mirënjohjen për mbështetjen e dhënë për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e drejtësisë në Republikën e Kosovës", ka shkruar në këtë letër ministri Tahiri.

Peja në vitin 2019 do të bëhet me Qendër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë



PEJË, 5 DHJETOR (ER) - Në kuadër të investimeve kapitale të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për vitin 2019, kjo ministri, në bashkëpunim me Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, do ta themelojë Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në këtë qytet, saktësisht në hapësirën e këtij universiteti.

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, për të lansuar këtë projekt të rëndësishëm ka vizituar të mërkurën Universitetin Publik të Pejës "Haxhi Zeka", në hapësirat e të cilit do të jetë

Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Gjatë kësaj vizite ministri Beqaj ka takuar rektorin prof. dr. Fadil Millaku, dekanin Halit Shabani dhe sekretarin Astrit Adema. Së bashku kanë vizituar ambientet e dedikuara nga universiteti për këtë qendër. Ministri Beqaj ka folur për rëndësinë e qendrës edhe para studentëve të shumtë të Universitetit të Pejës. "Është kënaqësi e veçantë ta shoh entuziazmin e madh të studentëve nga Peja me rrethinë, që ishin në numër kaq të madh, për t'i dëgjuar dhe për të bashkëbiseduar për idenë e

kësaj qendre", ka thënë ministri Beqaj. Ai ka shtuar se ky është një lajm i mirë për Pejë dhe themelimi i qendrës ka për qëllim ta lidhë shkencën me biznesin.

Beqaj ka theksuar rëndësinë e veçantë dhe potencialet e mëdha që ka ky rajon për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Ministri Beqaj u ka bërë thirrje të rinjve të kësaj ane që idetë dhe njohuritë e veta t'i zhvillojnë nëpërmjet inovacionit dhe ndërmarrësisë, në mënyrë që e ardhmja e tyre dhe e vendit të jetë e sigurt dhe e suksesshme.

Mehmeti: Sektori bankar, kontribuues në rritjen ekonomike të vendit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë, në Konferencën Vjetore të Bankave, se sektori bankar i Kosovës në vitet e fundit ka rritur në masë të konsiderueshme rolin për financimin e rritjes ekonomike në vend. Sipas tij, ky zhvillim pozitiv ka sjellë përmirësime të vazhdueshme në qasjen në financa, e cila për një kohë të gjatë është raportuar nga bizneset si një ndër barrierat kryesore për zhvillimin e afarizmit të tyre. "Standardet më të lehtësuara kreditore dhe zvogëlimi i normave të interesit në kredi kanë shërbyer si stimuj të rëndësishëm për rritjen e kërkesës për kredi, duke rezultuar në një rritje vjetore të kredive prej 11.6 përqindësh në muajin tetor të këtij viti. Në tetor 2018 norma mesatare e interesit në kredi ishte 6.6 për qind, që paraqet një përmirësim shumë të madh në krahasim me një periudhë jo shumë të largët, kurse norma e kredive joperformuese ishte 2.8 për qind, që pasqyron një gjend-

je shumë të mirë të cilësisë së portofolit kreditor. Këta tregues tregojnë se oferta për kredi është përmirësuar në masë të konsiderueshme. Vëmendje të veçantë dëshiroj t'i kushtoj cilësisë shumë të mirë të portofolit kreditor, e cila flet për menaxhim të mirë të rrezikut kreditor nga bankat, por lirisht mund të shërbejë edhe si një indikator i rëndësishëm i ambientit të favorshëm ekonomik për operimin e bankave në Kosovë", ka deklaruar guvernatori Mehmeti. Në fjalimin para të pranishmëve, guvernatori Mehmeti ka thënë se zhvillim i rëndësishëm në sektorin bankar është edhe përmirësimi në qasjen në financa, sidomos në sektorin e bujqësisë dhe sektorin e prodhimit, të cilët në vitin e fundit ka qenë sektorët me rritjen më të lartë të kredive të pranuar. Mehmeti ka thënë se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me të gjitha kapacitetet është në funksion të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar. Sipas tij, në vitet e fundit BQK-ja ka rritur angazhimin edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, duke i shër-



byer kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjes së interesit të publikut. "BQK-ja që nga fillimi i funksionimit të saj gjithmonë ka qenë dhe është në mbështetje të plotë të zhvillimit të sistemit financiar, por dëshiroj të theksoj se ne jemi të përkushtuar të sigurohemi se zhvillimi i institucioneve financiare të bëhet në përputhje të plotë me parimet e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve. Në këtë aspekt, ne jemi të ven-

dosur që ta rritim edhe më tutje angazhimin tonë në mbrojtje të të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare dhe kërkoj nga bankat që t'i shqyrtojnë me kujdes kërkesat ligjore dhe politikat e tyre për të shmangur çdo pengesë të paarsyeshme, e cila vështirëson ndërveprimin normal ndërmjet qytetarëve dhe sektorit bankar", ka thënë ai. Mehmeti ka thënë se BQK-ja do të vazhdojë t'i mbështesë të

gjitha aspektet e zhvillimit të sektorit bankar, duke ofruar gjithë infrastrukturën e nevojshme financiare dhe rregullatore. Në panelin e diskutimit me titull "Financimi i zhvillimit: Bankat për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës", zëvendësguvernatori i BQK-së, Sokol Havolli, ka folur rreth mundësive të ndërlidhjes së sektorit bankar me ekonominë me qëllim të fuqizimit të rritjes ekonomike.

Tetë milionë euro donacion nga Zvicra për sektorin e ujërave



PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me qeverinë zvicerane për bashkëfinancim dhe mbikëqyrje financiare të programit mbështetës për ujësjellës dhe kanalizime në zonat rurale. Ministri Valdrin Lluka dhe Alan Brown, udhëheqës i programit të ekipit Dorsch (Dorch International Consultants), nënshkruan këtë memorandum mirëkuptimi, i cili mundëson ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza në mbështetje të objektivit të qasjes gjithëpërfshirëse, infrastrukturës së komponentëve për zhvillim, duke i përfshirë edhe procedurat për operim

dhe mirëmbajtje, zvogëlim të ujit të pafaturuar, marrje të mostrave dhe monitorimit të cilësisë së ujit, mbrojtje të resurseve ujore, zbutje të ndryshimeve klimatike, efikasitet të energjisë dhe zhvillim të marrëdhënieve me konsumatorë në vende të ndryshme anembanë Kosovës. Qeveria e Kosovës në këtë projekt do të kontribuojë me 10 milionë euro, ndërsa Dorsch dhe qeveria zvicerane me tetë milionë euro. Ky projekt është në fazën e VI dhe do të vazhdojë deri në vitin 2021. Ky projekt do ta mundësojë integrimin e ujësjellësve të vegjël dhe atyre vetjakë në sistemin rajonal të ujësjellësit, duke përmirësuar shërbimin ndaj qytetarëve dhe duke rritur sigurinë në ujë të pijshëm.

Prokuroria e Shtetit do t'i hetojë manipulimet në ndërmarrjen "Ramiz Sadiku"

PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Të mërkurën para objektit të Prokurorisë të Shtetit, në Prishtinë, kanë protestuar ish-punëtorët e ndërmarrjes ndërtimore "Ramiz Sadiku", me përfaqësuesin e saj Idriz Zhinipotoku, të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre për shkak të mospagesës prej 20 përqindësh nga shitja e aseteve të kësaj ndërmarrjeje. Përfaqësuesit

e saj u pritën në takim nga zëvendëskryeprokuroreja e shtetit, Sevdije Morina dhe prokurori Idain Smajli, të cilët diskutuan për këtë rast. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit shprehën pakënaqësitë e tyre sa i përket manipulimit mbi ndërmarrjen e tyre dhe kërkuar që Prokuroria e Shtetit të merret me hetimin e listës së kësaj ndërmarr-

rje, duke theksuar se aty janë futur persona në mënyrë të pamerituar, të cilët edhe kanë marrë këtë përqindje, duke mos qenë asnjëherë pjesë e kësaj organizate. Prokuroria e Shtetit, me qëllim të ndriçimit të kësaj çështjeje, me përkushtim do të merret me hetimin e këtyre listave të cilat dyshohet se janë manipuluar.



Nis implementimi i projektit që ndihmon bizneset të eksportojnë në tregjet e huaja



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur në takim menaxherin e Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit në Bankën Botërore, Mario Gudamillas dhe Marco Mantovanelli, menaxher i Bankës Botërore për Kosovë, për fillimin e implementimit të Projektit të financuar nga Banka Botërore CERP (Konkurrueshmëria dhe Rritja e Aftësisë Eksportuese për NVM-të) në Republikën e Kosovës.

Ministri Shala ka theksuar se komponentët dhe aktivitetet e këtij

projekti do të përqendrohen konkretisht në fusha ku ambienti afarist në Kosovë ka nevojë për përmirësim dhe avancim. "Projekti CERP, i financuar nga Banka Botërore për periudhën e ardhshme pesëvjeçare, do të shihet si mundësi reale dhe mënyrë për t'i realizuar qëllimet dhe objektivat zhvillimore të MTI-së, përkrahjes së sektorit privat, si dhe objektivat zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përmirësimit të ambientit të të bërit biznes në veçanti. Komponentët dhe aktivitetet e këtij projekti do të përqendrohen kryesisht në këto fusha, konkretisht ku ambienti afarist në

Kosovë ka nevojë për përmirësim dhe avancim: Rritja e konkurrueshmërisë dhe aftësisë eksportuese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-të), përmirësimi dhe avancimi i sistemit të infrastrukturës kombëtare të cilësisë dhe reformimi i sistemit të inspeksioneve", ka theksuar Shala. Ministri ka bërë me dije se projekti i Bankës Botërore do ta rrisë aftësinë konkurruese dhe eksportuese të kompanive vendore në tregun regional dhe atë të Bashkimit Evropian. "Me qëllim të përkrahjes së NVM-ve me potencial eksportues, MTI-ja ndërmjet këtij projekti parashih implementimin e skemës së granteve të për-

puthshme duke përkrahur NVM-të në certifikimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre, përmbylljen e kërkesave të tyre për realizimin e standardeve ndërkombëtare, ofrimin e shërbimeve të konsulentës, hulumtimit të tregut, zhvillimit të strategjive të marketingut etj. Në këtë mënyrë NVM-të në vendin tonë do ta rrisin aftësinë konkurruese dhe eksportuese në tregun regional dhe atë të Bashkimit Evropian", ka thënë ai. Ministri Shala ka treguar se aktualisht NVM-të eksportuese nuk mund t'i përdorin raportet e testimit nga laboratorët e brendshëm apo certifikatat nga organizmat e brendshëm certifikuese të

produkteve kur ata i eksportojnë prodhimet e tyre. Ministrit Shala ka bërë me dije se reformimi i sistemit të inspeksioneve është komponentë e rëndësishme e këtij projekti. "Ne si MTI jemi të përkushtuar dhe do të punojmë për zvogëlim dhe eliminim të barrierave administrative për bizneset duke përmirësuar shërbimet dhe efikasitetin gjatë kryerjes së inspeksioneve. Gjithashtu, Qeveria është duke punuar për krijimin e infrastrukturës ligjore, respektivisht Ligjin gjithëpërfshirës për inspeksionet, në këtë mënyrë do të ofrohen mundësi për zbatim të suksesshëm të kësaj reforme", ka thënë ministri.

Haradinaj: Do të qëndrojmë këmbëngulës për fuqizimin e prodhimtarisë vendore

PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - "Realiteti i ri i krijuar nga Qeveria nëpërmjet politikave fiskale më të avancuarat në rajon si dhe tarifata e vendosura së fundi në importe ka ngritur parametrat e prodhimit vendor dhe ato të eksportit", kështu ka thënë të mërkurën kryeministri Ramush Haradinaj në hapjen e Konventës së Tretë Vjetore të përpunuesve të drurit. Sipas tij,


Kosova tradicionalisht është shquar për mjeshtri në përpunimin e drurit. "Sot me prodhimet e saj mund të konkurrojmë në cilindo treg. Së bashku do të qëndrojmë këmbëngulës për fuqizimin e prodhimtarisë vendore, si shtysë për hapje të vendeve të reja të punës dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik", ka thënë kryeministri Haradinaj.



Platforma 'Open Data' rrit besimin e qytetarëve në Komunën e Prishtinës

Prishtinë, 5 dhjetor (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se "Open Data" është një platformë e cila ka për qëllim rritjen e transparencës në qeverisje. Sipas kësaj komune, kjo platformë ka rritur besimin e qytetarëve në Komunën e Prishtinës. "Platforma 'Open Data' është mjet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm drejt një qeverisjeje transparente. Është formë e shpejtë e raportimit përballë qytetarëve, me paratë e të cilëve ne menaxhojmë. Përmes 'Open Data' ne si kryeqytet publikojmë secilin vendim, secilin

investim, secilën faturë, secilën kontratë dhe secilin dokument që del nga drejtoritë komunale. Hapja e tillë e të dhënave e ka rritur besimin e qytetarëve në Komunën e Prishtinës si dhe i ka bërë ata pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Sepse, kur qytetarët i kanë të gjitha informatat, nxiten për ide, vërejtje dhe sugjerime, të cilat neve në fund na shërbejnë si bazë për planifikimin e investimeve dhe projekteve në të ardhmen", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Përkujtohen dëshmorët e rënë në malet e Pashtrikut

RAHOVEC, 5 DHJETOR (ER) - Në 20-vjetorin e rënies së dëshmorëve të kombit Muhamet Malsori, Hysni Duraku, Skender Hameli, Sinan Hoti, Isak Hoti, Sedat Hoti, Sedat Hoti, Hida Hoti dhe Ismet Hoti janë bërë homazhe dhe nderime në respekt të jetës dhe veprës së tyre te varrezat e dëshmorëve në Krushë të Madhe si

dhe te vendi i rënies në malet e Pashtrikut. Në homazhe dhe nderime të pranishëm ishin shumë qytetarë për ta nderuar veprën e tyre si dhe kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, familjarë dhe bashkëlufëtare të dëshmorëve. Në fjalimin e mbajtur te vendi i rënies në malet e Pashtrikut,

kryetari Latifi ka çmuar lart veprën dhe sakrificën e të rënëve më 4 dhjetor të vitit 1998. Për nder të veprës dhe sakrificës së 8 dëshmorëve të Pashtrikut nën përkujdesjen e kryetarit të komunës, Smajl Latifi, u mbajt edhe akademi përkujtimore në Shtëpinë e Kulturës "Muhamet Malsori" në Krushë të Madhe.

Haskuka: Prizreni ka larguar më së shumti deponi ilegale

PRIZREN, 5 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije se kjo komunë ka larguar më së shumti deponi ilegale të mbeturinave gjatë këtij viti. Ai

ka thënë se në këtë vit Komuna e Prizrenit ka larguar 29 deponi ilegale të mbeturinave. "Sipas raportit të 'ndreqe.com', Komuna e Prizrenit ka larguar më së shumti deponi ilegale në

vitin 2018. Deri në shtator janë raportuar 19 deponi, komuna i ka larguar 29 deponi. Por duhet ende punë dhe vetëdijesim për Prizrenin e gjelbër", ka deklaruar Haskuka.



Hoti nënshkruan marrëveshje për Programin Nacional për Rininë edhe me Suharekën

SUHAREKË, 5 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, dhe kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e Programit Nacional për Rininë në këtë komunë. "Programi Nacional për Rininë është hartuar për të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës të nivelit fillor, të

mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Në kuadër të këtij programi do të organizohen gara në tri fusha kryesore: dituri, kreativitet kulturor dhe mendim kritik si dhe në sport. Për të tria fushat janë përgatitur udhëzuesit për rrjedhën e garës. Roli i komunës për realizimin e këtij programi është shumë i rëndësishëm, prandaj ju falënderoj për mbështetje", ka thënë koordinatori Hoti. Ndërsa kryetari Muharremaj ka

shprehur gatishmërinë për realizimin e Programit Nacional për Rininë. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet KNKRS dhe Komunës së Suharekës përcakton angazhimet e ndërsjella të palëve nënshkruese për implementimin e Programit Nacional për Rininë dhe për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve që kanë të bëjnë me diturinë, kreativitetin kulturor dhe mendimin kritik si dhe sportin.


Kërcënohet kryetari i Kllokotit

Kllokot, 5 dhjetor (ER) - Policia e Kosovës ka bërë me dije se dy persona e kanë kanosur verbalisht kryetarin e Komunës së Kllokotit, Bozhidar Dejanović. Kryetari i Komunës së Kllokotit ka raportuar se më 3 dhjetor është kanosur verbalisht nga dy persona të dyshuar S. J. dhe Z. J. (babë e bir), që të dy nga fshati Grncar i Kllokotit. Menjëherë pas marrjes së këtij informacioni njësitet relevante policore kanë ndërmarrë veprimet e tyre operative për hetimin e rastit dhe intervistimin e personave të dyshuar të përfshirë në këtë rast. "Bazuar në informacionet e siguruar,

arsyeja për sulmin verbal dhe kërcënimet ndaj kryetarit të komunës dyshohet se kanë ndodhur pasi i dyshuari S. J. është larguar nga lista e marrjes së asistencës sociale përmes Komunës së Kllokotit", ka njoftuar Policia e Kosovës. Sipas Policisë, gjatë trajtimit të rastit nga njësitet policore është konstatuar se një nga personat e përfshirë në këtë rast (S. J.) dyshohet se ka qenë nën ndikim të alkoolit. Në konsultim me prokurorin kompetent është iniciuar rasti "kanosje", me vendim të të cilit rasti është proceduar në procedurë të rregullt.



Kërkohet mobilizim i institucioneve përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë



**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ndotja e ajrit në Kosovë është shqetësuese për shëndetin e qytetarëve, edhe më shqetësues është fakti se institucionet përgjegjëse ende nuk kanë ndërmarrë masa konkrete për të përmirësuar këtë gjendje, ndërsa në anën tjetër qytetarët nuk janë të informuar me kohë lidhur me këtë problematikë. Bazuar në ndikimin dhe rëndësinë e madhe që ka kjo problematikë në shëndetin e qytetarëve, Zyra Kombëtare e Auditimit ka ndërmarrë dy auditime lidhur me mbrojtjen e

mjedisit dhe cilësinë e ajrit. Në vitin 2016 është publikuar raporti "Qëndrueshmëria e masave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit", ndërsa në muajin maj të vitit 2018 është publikuar raporti "Mekanizmat institucionalë për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit". Raportet e auditimit tregojnë se kontrollet e cilësisë së ajrit në Kosovë nuk janë mbështetur dhe fuqizuar plotësisht nga korniza e nevojshme ligjore, si dhe sistemi i monitorimit dhe raportimit nuk është plotësisht funksional. Po ashtu, në nivel lokal ekzistojnë parregullsi të ndryshme për miratimin e

planeve lokale për mjedis, për raportimin e zbatimit të këtyre planeve si dhe për përtëritjen e planeve në momentin kur ato nuk janë të vlefshme. Të dy auditimet kanë konstatuar, midis të tjerash, se parametrat e rrezikshëm për shëndetin e njeriut, siç janë grimcat e pluhurit PM10 dhe PM2.5, nuk janë raportuar për muaj të tërë, e sidomos gjatë muajve të dimrit kur këta parametra arrijnë vlera maksimale. Pavarësisht prej monitorimit dhe raportimit të mangët, në ato raste kur është raportuar, janë regjistruar tejkalime alarmante të parametrat PM10 që kanë arritur deri në 400 për qind tejkalim të

vlerave normale.

Ajri i ndotur ka ndikim të konsiderueshëm në shëndetin e qytetarëve dhe në ekonomi, duke shkurtuar jetëgjatësinë e qytetarëve, rritur kostot mjekësore si dhe reduktuar produktivitetin e ditëve të punës. Përkundër faktit që Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë rekomandimet e veta, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit, institucionet përgjegjëse ende nuk kanë hartuar planet e veprimit, duke treguar mungesën e vullnetit dhe përgjegjësisë institucionale që shqetësimet lidhur me mjedisin dhe cilësinë e ajrit të adresohen me kohë.

Lidhur me këtë Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse, përkatësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Institutit Hidrometeorologjik si dhe komunave, që të vazhdojnë t'i trajtojnë me prioritet rekomandimet të cilat rezultojnë nga auditimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit për ta përmirësuar gjendjen aktuale. Përmirësimi i ngecjeve të identifikuara do të ndihmojë në identifikimin e masave konkrete për ta përmirësuar gjendjen e cilësisë së ajrit.

Çmimi i importit rritet për 0.8 për qind në Kosovë

PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e tretë (TM3) 2018. Indeksi i tërësishtëm i çmimeve të importit në Kosovë u ngre 0.8 për qind në TM3 2018 krahasuar me TM2 2018. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishte te: prodhimet minerale (5.6 për qind); këpucët (4.8 për qind); lëkura dhe artikujt prej saj (2.5 për qind); prodhimet e industrive kimike (1.8 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt prej tyre (1.7 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (1.5 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet prej tyre (1.4 për qind); artikujt e gurit, llaçit, prodhimet e qeramikës dhe të qelqit (0.8 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.6 për qind); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (0.5 për qind); letrat dhe artikujt prej saj (0.2 për qind);

mjetet e transportit (0.1 për qind) dhe druri dhe artikujt e drurit (0.1 për qind). Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te prodhimet bimore (-6.9 për qind); tekstili dhe artikujt prej tij (-2.7 për qind); pajisjet e makinerisë dhe elektrike (-0.8 për qind); vajrat ushqyese (-0.3 për qind); dhe metalet bazë dhe artikujt prej tyre (-0.1 për qind). Ndërkaq, krahasuar TM3 2018 me TM3 2017, çmimet e importit u ngrahën në një mesatare prej 2.2 përqindësh. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: prodhimet minerale (20.5 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt prej tyre (5.7 për qind); druri dhe artikujt prej tij (3.9 për qind); artikujt e gurit, llaçit, prodhimet e qeramikës dhe të qelqit (2.8 për qind); metalet bazë dhe artikujt prej tyre (2.3 për qind); prodhimet e industrive kimike (2.0 për qind); mjetet e transportit (1.4 për qind); lëkura dhe artikujt prej saj (1.0 për qind); vajrat ushqyese (0.2 për qind); dhe



instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (0.2 për qind). Ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sek-

torëve te: prodhimet bimore (-14.2 për qind); këpucët (-10.0 për qind); letra dhe artikujt prej saj (-7.3 për qind); tekstili dhe artikujt prej tij (-3.9 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet

prej tyre (-2.2 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (-1.1 për qind); pajisjet e makinerisë dhe elektrike (-1.1 për qind) dhe artikujt e ndryshëm të prodhuar (1.5 për qind).

Pse po aktualizohet ideja e presidentit konsensual në Maqedoni?

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, thotë se Maqedonisë i duhet një president konsensual, përkatësisht të arrihet marrëveshje mes partive politike, për një figurë e cila bashkon të gjithë qytetarët e Maqedonisë

SHKUP, 5 DHJETOR - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, pesë muaj para mbajtjes së zgjedhjeve të presidenciale, sërish e ka promovuar idenë për president konsensual. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" shprehet se Maqedonisë i duhet një president konsensual, përkatësisht të arrihet marrëveshje mes partive politike, për një figurë e cila unifikon të gjithë qytetarët e Maqedonisë. "Mendoj se nuk jemi shumë larg idesë që vendit i duhet një president konsensual, një president i dalë nga marrëveshja. Mirëpo, ende nuk kemi biseduar për detaje dhe mendoj se në të ardhmen, pasi t'i mbyllim këto procese kaq të mëdha që i kemi, mund të flasim edhe për këtë temë. Por, ne parimisht i qëndrojmë atij parimi për të

cilin jo një herë, por disa herë jemi deklaruar në të mirë të vendit", theksoi Ali Ahmeti. I pyetur se nëse dështon ideja për presidentin konsensual, a mendon se shteti duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare bashkë me ato presidenciale, të cilat duhet të mbahen në pranverën e vitit të ardhshëm, Ahmeti është shprehur i prerë, se Maqedonisë si shtet nuk i duhen zgjedhje të parakohshme, por fokusim i të gjitha forcave relevante në realizimin e obligimeve, për ta përsheptuar procesin e integritetit euroatlantike. "Mendoj se nuk ka nevojë për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Ne duhet t'i materializojmë dhe t'i zbatojmë detyrat, obligimet dhe programet që i kemi qoftë

si Qeveri, qoftë si parti politike, që marrim pjesë në koalicionin qeverisës. Dhe mendoj se për vendin do të ishte më e dobishme të shkohet në zgjedhje të rregullta dhe me sukses të arrijmë t'i përmbyllim zgjedhjet për president të shtetit sa më mirë dhe të gjejmë gjuhë të përbashkët, që këtë proces ta përmbyllim bashkërisht", thotë Ahmeti.

Ndryshe, zgjedhjet e fundit presidenciale të cilat u mbajtën në vitin 2014, Bashkimi Demokratik i bojkotoi, sepse nuk u pranua ideja e kësaj partie për kandidat konsensual, me ç'rast atëkohë kjo parti u bëri thirrje shqiptarëve të mos votojnë për asnjë nga kandidatët për president. Por, Aleanca për Shqiptarët konsideron se Ali Ahmeti me hedhjen e kësaj ideje në opinion, në momentin që janë në procedurë ndryshimet kushtetuese, ka për synim ta shpërqendrojë vëmendjen e opinionit.

"Ahmeti këtë ide e aktualizon në momentin kur janë në procedurë parlamentare

ndryshimet kushtetuese, që janë shumë të rëndësishme për shqiptarët, sidomos kur nevojitet që në Kushtetutë të figurojë gjuha shqipe si gjuhë zyrtare dhe jo gjuhë që e flasin 20 për qind e popullatës. Po në këtë periudhë ai del me idenë e presidentit konsensual e që, në fakt, qëllimi është vetëm ta shpërqendrojë opinionin nga diskutimi mbi çështjet që janë jetike për momentin dhe që nuk do të përsëritet ky shans 20 vjetët e ardhshëm - hapja e Kushtetutës - duke vënë theksin në një temë e cila absolutisht është e parëndësishme në këtë kohë", thonë zyrtarë të kësaj partie. "Ne si parti kemi mbrojtur qëndrimin që presidentin e shtetit më së miri do të ishte ta zgjedhë Parlamenti dhe aty të arrihet konsensus mes të gjitha partive dhe jo vetëm atyre shqiptare", thotë Arben Taravari, sekretar i Aleancës për Shqiptarët.

Edhe Lëvizja Besa e Bilall Kasamit, e cila nuk është pjesë e Qeverisë, edhe pse me dy deputetët e saj në Parlament ka

mbështetur ndryshimet kushtetuese, thotë se presidenti konsensual është i mundshëm vetëm nëse ndryshohen dhe modeli i zgjedhjes së presidentit, përkatësisht presidentin e shtetit ta zgjedhë Parlamenti. "Sa i takon idesë së presidentit konsensual, mendojmë se kjo ide mund të zhvillohet vetëm në momentet nëse presidenti i shtetit do të zgjidhet nga Parlamenti. Njëherësh, për të qenë presidenti i shtetit konsensual, duhet të përdoret mekanizmi i mbrojtjes nga mbivotimi, i njohur si votimi i dyfishtë apo votimi mbi bazë të mekanizmit të Badinterit", tha ai. "Çdo alternativë tjetër e hedhur në opinion se mund të gjendet një kandidat konsensual, ai mund të jetë një kandidat për të cilin do të bien në ujdj partnerët e koalicionit qeverisës, pasi në asnjë moment nuk mund të quhet kandidat për president konsensual një person për të cilin arrijnë marrëveshje dy ose tri parti politike", thotë Arianit Hoxha nga Lëvizja Besa.

Ndërkaq nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), e cila drejtohet nga kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, thonë se brenda partisë ende është duke u diskutuar për këtë çështje. "Ende është herët të flasim për këtë çështje, kryekëput jemi të fokusuar në çështjet që ndodhin në Parlament rreth ndryshimeve kushtetuese, për realizimin e Marrëveshjes me Greqinë për çështjen e emrit", tha zëdhënësi i LSDM-së, Konstantin Kosnastadinov. Edhe nga VMRO-DPMNE-ja theksojnë se nuk është hapur brenda partisë tema rreth zgjedhjes së presidentit të shtetit. Kjo çështje, shtojnë nga kjo parti opozitare, nuk është diskutuar as me partitë e tjera. "Një gjë është e sigurt, se kandidati me të cilin do të futemi në garë do të jetë personalitet i ndershëm, që do ta respektojë Kushtetutën dhe do të kujdeset për interesat strategjike për shtetin", kanë theksuar nga VMRO-ja.



Armen NIMANI (AFP)

Putin: ShBA e konsideroi keq tërheqjen nga pakti për kontrollin e armëve

MOSKË, 5 DHJETOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se plani i ShBA-së për tërheqje nga një pakt për kontrollin e armëve është "konsideruar keq" dhe paralajmëroi se Moska do të ndjekë shembullin nëse Uashingtoni tërhiqet nga Traktati i Forcave me Rreze të Mesme, i vitit 1987.

Putin i bëri këto komente një ditë pasi Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha në një takim të NATO-s në Bruksel

se Uashingtoni do ta braktisë traktatin pas 60 ditësh, nëse Moska nuk i çmonton raketat që ShBA-ja konsideron se përbëjnë shkelje të marrëveshjes. "Është e thjeshtë për ShBA-në të fajësojë Rusinë. Por, ky nuk është rasti. Ne jemi kundër shkatërrimit të traktatit", tha Putini. "Çfarë do të bëjmë ne në përgjigje? Shumë thjesht: do ta bëjmë të njëjtën", tha Putini. Më herët, Valery Gerasimov, shef i Shtabit të përgjithshëm



të Forcave të Armatosura ruse, tha se tërheqja e ShBA-së nga traktati "do të ishte një hap i rrezikshëm që do të mund të ndikonte negativisht jo vetëm në sigurinë evropiane, por në të gjithë stabilitetin strategjik". Traktati ShBA - Rusi, i cili daton nga Lufta e Ftohtë dhe ka eliminuar një klasë të tërë të raketave nga Evropa, konsiderohet kyç për stabilitetin strategjik mes Uashingtonit dhe Moskës.

Recension

Për 'Si kripën të kam dashtë' të autorit Molliqaj

Albin MEHMETI

Arif Molliqi, i cili në indeksin e letërsisë shqipe ka regjistruar vepra me poezi, me prozë, me dramë, me monografi, këtë vit bibliografisë së vet i rendit edhe një libër poetik, me titull "Si kripën të kam dashtë", botuar nga shtëpisë botuese "Armagedoni". Molliqi nëpërmjet kësaj veprë na sjell krijimtarinë e vet poetike të shkruar në dhjetë vjetet e fundit. Përmes lirikave të pastra do të na shfaqen si në tablo gëzimet e vuajtjet, dashuritë dhe hidhërimet e autorit që shpeshherë bëhen edhe vuajtje, gëzime dhe hidhërimet kolektive, kombëtare dhe mbarënjëzore.

Autori e nis veprën me poezinë "Kronikë e një fotografie", poezi që nuk bën pjesë në asnjë prej pesë kapitujve sa ka libri. Në këtë poezi autori gjendet mes dy kohëve, të kaluarës, e cila ka mbetur vetëm si një kujtim në fotografinë e vjetër dhe të tashmes, pleqërinë e së cilës e portretizon përmes borës së bardhë mbi kokë, që nuk shkrihet në asnjë stinë.

Jetë mërgimtari

Në poezitë e Molliqit kemi të pasqyruar gjithë ndjenjën e brendshme të tij. Fati i jetës e detyroi atë të migrojë larg vendlindjes, larg Llukës që e përshkruan me dashuri. Vendlindja, në poezitë e tij, gjendet mes dy ndjenjave, mes dashurisë që ndjen për çdo gjë që lidhet me të, madje edhe për erën e luleve. Në anën tjetër kemi dimensionin e

vuajtjes për tokën e harruar, për portat që s'ka kush t'i trokasë dhe për oxhaqet e braktitura. Më tej, Molliqi sikur shfryen gjithë mllëfin edhe ndaj Evropës. Përmes vargjeve të tij, ai na jep një Evropë tjetër nga ajo që proklamohet çdo ditë. Shohim një Evropë që nuk është strehë mikpritëse. Në ciklin "Fshati me një refugjat" shohim përshkrimin më të mirë se si fyhet dhe paragjykohet i huaji në një fshat evropian, se si neglizhohet nga shoqëria, ku jepet më së miri përmes vargjeve: "Kërkimet e mia sterile; drejt një porte të mbyllur".

Fatkeqësia e mërgimtarit nuk mbaron me kaq. Pa dyshim se është e rëndë të vritesh e të harrosh nga i huaji. Kjo mbase e ka një derë, do të thoshte populli. Por, mërgimtari shqiptar fillon të ndihet i huaj edhe në vendin e tij të lindjes. Në poezinë "Promenadë verore apo limonadë kulturore", Molliqi përshkruan një fenomen që nuk duhet as të paramendohej e lëre më të ndodhte, neglizhenca e autorëve mërgimtarë në vendlindje, ku librat e tyre, lëre që nuk i gjen nëpër biblioteka, por harrohen edhe nga kolegët e tyre të penës.


Dhimbja

Ajo që i shquan poezitë e Arif Molliqit është dhimbja, që na derivon në disa variante, si dhimbje personale, ajo që lidhet me kurbetin, të cilën e hasim në një pjesë të madhe të poezive, si: dhimbje familjare për vëllanë, Sadikun dhe motrën në poezitë "loja e dhimbjes" dhe "motër-madhes", në të cilat poeti shkrinë

gjithë mallin dhe dhimbjen që ka për humbjen e më të dashurës; si dhimbje kombëtare për tragjeditë që iu ndodhën shqiptarëve ndër shekuj, për Çamërinë e harruar të Bilal Xhaferit, për Shkupin në të cilin "... dy mijë vjet më parë pas erdhi djalli; me zhurmë, vrasje e dehje gjaku; e zeza u shfaq mbi qeleshen e bardhë", për kufijtë që "...për hatër të lëvizjes së lirë; e hëngrëm bjeshkën tonë"; dhe si dhimbje njëzore tejkombëtare, racore dhe fetare për luftërat e gjakderdhjet gjithandaj ku dhimbje e tillë portretizohet në poezinë "Aleppo", ku autori si sinonim i gjithë njerëzimit, i dëshpëruar dhe i prekur thellë nga skenat makabre, thotë: "O Zot, ç'kuptim ka frymëmarrja ime kur s'i ndihmon askujt". Kjo dhimbje është edhe më e madhe kur ekzistojnë njerëz që, sipas Molliqit, luftën e shohin vetëm si logaritje e si shifër dhe jo si dhimbje e terror.

Njeriu, kriminel i shumëfishtë

Që nga poezia e parë e deri tek e fundit Arif Molliqi godet fenomene dhe dukuri, të cilat dita-ditës shkatërrojnë botën. Pena e mprehtë e tij godet njeriun si fajtorin që solli gjithë të këqijat. Për Molliqin njeriu është kriminel i shumëfishtë. Njeriu i sotshëm, duke u thirrur në metanarracione, ku spikat patriotizmi i rrem, vret dhe mashtron atdheun dhe bashkëvendësit e vet. Në poezinë "Ishte vonë për të thënë diçka", goditen fuqishëm matrapazët që me ironi i quan tregtarë të flamujve, të cilët çështjen e shohin si biznes dhe si trampolinë për të



arritur famë.

Sot njeriu nuk vret vetëm njeriun, por vret çdo gjë që i del para, madje nuk kursen as natyrën. Në poezinë "Vrasja dhe vdekja e Lumëbardhit" përmes një dhimbje të madhe, Molliqi fajëson "katërkëmbëshit (që) flasin dhe veprojnë", të cilët ia gatitën vdekjen dhe ia hapën varrin Lumëbardhit.

Dilema molliqiane

Në poezinë "Dilemë jete", Molliqi ka një dilemë të madhe para vetes, se si të veprojë: të qëndrojë në ishullin që po e braktisin apo të shkojë në pyllin me kope ujçërve. Përmes kësaj metafore shprehet gjendja e amullt e një të riu kosovar që gjendet para një dileme të madhe, të qëndrojë në vendlindjen që po braktiset dita-ditës apo të ikë drejt Evropës të cilën e përshkruan si vend ku njeriu dëshiron ta hajë njeriun. Molliqi nuk jep

sugjestion se cila është zgjidhja. Na lë neve të zgjedhim mes ishullit me tym e mjegull apo vendeve me labirinte të panjohura.

Dashuria e përjetshme

Vetë titulli i veprës "Si kripën të kam dashtë" na lë të nënkuptojmë se kemi të bëjmë me poezi erotike. Duke njohur zotësinë e Molliqit, nuk është për t'u habitur nëse shohim që edhe konceptin e dashurisë ta konceptojë. Në poezinë "Letra e humbur" do të shohim se dashuria për autorin nuk mbaron me vdekjen, madje ajo vetëm përforcohet. Dashuria në këtë poezi, por edhe në poezi të tjera të tij, është dashuri e përjetshme, që s'ka fund.

Përmes veprës "Si kripën të kam dashtë", Arif Molliqi dëshmoi gjenialitetin prej shkrimtari. Ai u bë zëri i të gjithë neve që dëshirojmë një botë më të mirë, një botë me dashuri.

Ministri Gashi: Kosova çdo ditë e më shumë po mbron autorin

PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë të mërkurën në Konferencën Rajonale "E drejta e autorit në kohën digjitale" e cila u organizua nga Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Me këtë rast, ministri Gashi ka folur rreth rëndësisë së krijimtarisë kulturore, inovacionit dhe zhvillimit të së drejtës së autorit në vendin tonë. "Kreativiteti dhe novacioni janë baza e krijimtarisë kulturore dhe ekonomike e një shoqërie. Edhe në kohën digjitale veprat e autorit krijohen me shumë mund dhe investim, ndërsa teknologjia ka bërë të mundur që kopjet digjitale të veprave të bëhen shpejt dhe me shumë pak shpenzime e mund",

ka thënë ministri Gashi. Ai u shpreh i vendosur për ta vazhduar punën për mbrojtjen e të drejtës së autorit në ambientin digjital. "Puna jonë ka qenë e bazuar në krijimin e sistemit të së drejtës së autorit dhe në luftimin e piraterisë fizike edhe ashtu në zhdukje falë zhvillimit të teknologjisë, institucionet ligjzbatuese në kuadër të task forcës kundër piraterisë, inspektorati i tregut, Policia dhe Dogana e Kosovës të koordinuara nga Zyra për të Drejtën e Autorit, kanë marrë masa të vazhdueshme kundër shkeljeve të së drejtës së autorit, mijëra mallra pirate janë sekuestruar dhe konfiskuar", ka deklaruar ministri Gashi. Ai ka theksuar se viti 2018 është

viti i të drejtës së autorit për Kosovën pasi, sipas tij, pas pesë vjetëve negociata është arritur marrëveshja e parë dhe historike për tarifën e përgjithshme për shfrytëzimin e muzikës nga transmetuesit në territorin e Republikës së Kosovës janë miratuar tarifën për kompensime të veçanta. "Ministria që drejtoj unë deri në fund të marsit të vitit 2019 do t'i propozoj edhe tarifën për operatorët kabllorë, në këtë mënyrë do të funksionalizohet menaxhimi kolektiv i të drejtave të autorit. Ne jemi duke ecur përpara dhe sigurt për të krijuar një ambient ku të drejtat e autorit zbatohen dhe autorët e krijuesit gëzojnë mbrojtje dhe përfitime ekonomike nga veprat e tyre. Kosova çdo ditë e më shumë po



mbron autorin", është shprehur ministri Gashi. Në fund ministri Gashi ka falënderuar për pjesëmarrjen e tyre përfaqësuesit e

Zyrës hungareze dhe të asaj shqiptare dhe avokatët Randaza nga ShBA-ja dhe Bogataj nga Slovenia.

E rrallë

Tri javë pas fluturimit, pasagjeri gjobitet me 300 dollarë nga linja ajrore

Para çdo fluturimi, pasagjerët këshillohen t'i fikin celularët. Ky veprim bëhet për siguri, në mënyrë që të mos rrëzohet avioni. Një pasagjer e ka pësuar vetëm se nuk zbatoi



regullin. Pas tri javësh që kishte udhëtuar me avion, ai mori gjobën 300 dollarë për mosfikjen e celularit.

FOTO E DITES



Një djalë i ri afgan shihet duke shitur qymyr në qytetin e Heratit. /AFP/

E jashtëzakonshme

Në këtë qytet norvegjez është e ndaluar të vdesësh

Duket e pabesueshme, por është e vërtetë. Ka një vend në botë ku vdekja është e ndaluar. Kjo do të thotë që nëse keni pësuar një aksident të rëndë, apo jeni shumë i sëmurë ose gati të vdisni, ata ju largojnë nga qyteti dhe ju dërgojnë në një tjetër vend. Po flasim për qytetin norvegjez Longyearbyen, që ndodhet në ishullin Svalbard, midis kontinentit të



Norvegjisë dhe Polin të Veriut. Sipas të dhënave të saj demografike, ky vend konsiderohet zgjidhja më veriore e planetit dhe popullsia e saj është pak më shumë se 1 000 veta.

BARSOLETA E DITËS



- A tutesh prej merimangës, babi?
- Jo more çfarë!
- Ani dil jashtë se ta mori veturën.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Ndjenjat dhe pasioni sot do të jenë të ndara nga njëri-tjetri për ju. Çdo gjë që ka të bëjë me anën sentimentale nis e përfundon shumë shpejt.</p>	 <p>DEMI Jeni mjaft të vëmendshëm sot ndaj nevojave të partnerit për shkak të largësisë që për disa kohë ju ka lënë të dy larg njëri-tjetrit.</p>	 <p>BINJAKËT Sot jeni fokusuar të karriera dhe të gjitha energjitë tuaja do të shpenzoni për atë duke lënë shumë pak hapësirë për pjesën sentimentale.</p>	 <p>GAFORRJA Ankoheni për çdo gjë sot dhe kjo do të sjellë pakënaqësi në ambiente të caktuara. Mos ekzagjeroni me situata që nuk janë aspak të rëndësishme.</p>	 <p>LUANI Mundohuni të realizoni në praktikë çdo ide që keni menduar kohët e fundit. Kështu do të kuptoni nëse ia vlen vërtet mundim</p>	 <p>VIRGJËRESHA Jeni romantikë të lindur dhe në çdo çast visheni me nostalgji për kohë dhe persona të caktuar. Duhet të jeni pak më me këmbë në tokë së fundmi.</p>
 <p>PESHORJA Dita do t'u kushtohet blerjeve të ndryshme sot, madje edhe gjëra që nuk i keni fare të nevojshme. Miqtë përpiqen t'ju rrinë pranë në një situatë të</p>	 <p>AKREPI Në fushën e ndjenjave ndiheni dominues karshi partnerit. Në punë ka të papritura jo të</p>	 <p>SHIGJETARI Këndshme. Ka tension në familje sot lidhur me një vendim të caktuar që duhet të merrni bashkërisht. Shumë situata të ardhshme varen nga dita e sotme.</p>	 <p>BRICJAPI Shëndeti paraqitet mirë edhe me disa shqetësime të vogla kohët e fundit. Jeni i përpiktë në dietën e përditshme.</p>	 <p>UJORI Kjo javë nuk është dhe aq relaksuese për ju. Puna ju lodh, por fitimet monetare e justifikojnë këtë gjë. Ndiheni të sigurt me miqtë tuaj.</p>	 <p>PESHQIT Jeni mjaft praktik dhe arrini t'i zgjidhni problemet sapo ju paraqiten. Edhe pse në tension, sot për një çështje të caktuar do t'ia dilni mbanë.</p>


Travis Scott mohon tradhtinë ndaj Kylie Jennerit



Travis Scotti ka mbrojtur veten kundër thashethemeve që ai e tradhtoi gruan e tij Kylie Jenner. E gjitha filloi kur doli një fotografi e një personi që ngjante me reperin në një ballkon duke përqafuar një femër tjetër e cila nuk ishte Kylie.

Travis hyri në "Instagram" për të komentuar mbi fotografinë. "Gjithmonë do të ketë lajme të rreme për të shkatërruar një dashuri. Kam vetëm dashuri për gruan time. Nuk kam kohë për të humbur. Provoni përsëri", ka shkruar ai.

Travis Scott mohon tradhtinë ndaj Kylie Jennerit



Travis Scotti ka mbrojtur veten kundër thashethemeve që ai e tradhtoi gruan e tij Kylie Jenner. E gjitha filloi kur doli një fotografi e një personi që ngjante me reperin në një ballkon duke përqafuar një femër tjetër e cila nuk ishte Kylie.

Travis hyri në "Instagram" për të komentuar mbi fotografinë. "Gjithmonë do të ketë lajme të rreme për të shkatërruar një dashuri. Kam vetëm dashuri për gruan time. Nuk kam kohë për të humbur. Provoni përsëri", ka shkruar ai.



Swifti për herë të tretë fiton albumin më të mirë të vitit në Billboard

Këngëtarja amerikane Taylor Swift ka fituar për herë të tretë gjatë karrierës së saj në Billboard albumin më të mirë të vitit. Albumi "Reputation" është i

treti në radhë i 28-vjeçares që fitoi si albumi më i mirë i vitit. Dy albumet e tjera që fituan ishin "1989" në vitin 2015 dhe "Fearless" në vitin 2019.

Cardi B ndahet nga bashkëshorti



Cardi B ka thënë se ajo dhe bashkëshorti i saj Offset janë ndarë vetëm pas një viti martesë. Reperja 26-vjeçare e "Bodak

Yellow" e ka bërë dije këtë lajm përmes llogarisë së vet në "Instagram" duke thënë se ata thjesht nuk janë më të dashuruar.

Pablo Escobar, 25 vjet më parë u vra super-trafיקanti i drogës!

Disa e kujtojnë si “Robin Hood”-i i Kolumbisë, por për shkak të tij në 20 vjet humbën jetën mijëra persona. Vila e tij bunker, do të bëhet një park lojërash në kujtim të viktimave

Ka përfunduar në një tarracë të Medellinit, në 2 dhjetor të vitit 1993 historia më e madhe e narko-trafיקantit në botë: nën goditjet me armë të policisë, 25 vjet më parë do të vritej Pablo Escobar, baron i kokainës. Një skenë që është portretizuar edhe në një pikturë të famshme të kolumbianit Fernando Botero. Atë ditë – një ditë pas 44-vjetorit të lindjes dhe pesë muaj pasi u shfaq në për të shtatën herë në listën e “Forbes”, për njerëzit më të pasur të planetit – trupi i gjakosur i Escobar-it që ndodhej mbi tarracë, shfaqej

'90.

I mallkuar, i pranuar me turp, ndonjëherë i nderuar, por kurrë nuk u injorua. “Shefi” përgjegjës për mijëra vdekje është bërë një fenomen që tejkalon kufijtë e Kolumbisë. Trafiku i drogës shkaktoi të paktën 3 mijë të vdekur dhe frika mbizotëronte jetën e përditshme në ato vite, por Escobar mishëroi një model të “hakmarrjes sociale për të varfrit”, të cilëve iu dha “shtëpi, punë, para dhe bizhuteri”, thotë Omar Rincon, ekspert i Universitetit të Los Andes. Aq shumë që shumë e kujtojnë atë



luksoze, veshin këmisha me jakë të hapur, që zbulojnë zinxhirët e floririt në qafë, ndoshta duke mbajtur afër një bionde të lyer, ato janë për shumë njerëz simbole të suksesit.

“Ne nuk duam që të ketë fëmijë që thonë se duan të jenë si Pablo Escobar kur të rriten”, – shpjegon Manuel Villa, Kancelari i qytetit të Medellin, i cili ka nisur numërimin së prapthi para shkatërrimit të ndërtesës Monako. Pallati gjigant i bardhë tetë-katësh, ku Escobar ka përjetuar periudhën e fundit, simbol dekadent dhe pasuri e mafies kolumbiane në vitet '80 dhe '90, ka rënë në gjendje e keqe në vitet pas vdekjes së trafיקantit më të madh të drogës.

Ai mbart ende plagët e sulmit të parë me bomba të makinave në Kolumbi në vitin 1988, që shënoi fillimin e një lufte të përgjakshme ndërmjet karteleve rivale të drogës. Prishja është caktuar për në muajin shkurt 2019. “Monako është bërë një vend i faljes për krimin dhe terrorizmin. Më shumë se shkatërrimi i asaj


ndërtese, prishja ka të bëjë me shkatërrimin e një strukture në aspektin mendor”, thotë Villa. Sipas autoriteteve të Medellinit, në dhunën e trafikut të drogës janë vrarë 46,612 persona në mes

të vitit 1983 dhe 1994. Parku do të ndërtohet në vend të ndërtesës dhe do të kushtojë 2,5 milionë \$, ndërsa rinovimi i shtëpisë së shkatërruar do të kushtojë 11 milionë dollarë.



nga televizionet dhe u konsiderua nga policia si një “trofe”. Që atëherë, përvjetori është përjetuar në Kolumbi si një përzierje mes urrejtjes dhe adhurimit, dhimbjes dhe mirënjohjes. 25 vjet më vonë, autoritetet po përgatiten të prishin ndërtesën e Monakos, selia-bunker e mbretit të trafikut të drogës, në rrethin e El Poblado. Në vend të saj do të ndërtohet një park publik i dedikuar për mijëra njerëz të vrarë në Kolumbi nga ‘narkoterrorizmi’, pra në luftën midis karteleve të drogës që luftuan njëra me tjetrën dhe kundër shtetit në vitet '80 dhe

si “Robin Hood kolumbian”. Për Escobar-in shkroi fituesi i çmimit “Nobel”, Gabriel Garcia Marquez në “Notizia di un sequestro” e tij dhe kohët e fundit historia e tij ka frymëzuar “Netflix”-in me serinë televizive “Narcos”. E veja dhe fëmijët e tij, si dhe vëllai dhe e dashura më e njohur, shkruan për jetën e tyre pranë tij; si dhe policët që luftuan kundër tij dhe ish-krahu i tij i djathtë, Popeye. Në fund, shijet ekstravagante të atyre që nga një kriminel i mitur, u bë një nga njerëzit më të pasur në botë, nuk e kontaminuan vetëm mafien: sot ata që shëtisin me makina



Në portin e marinarëve të arrestuar: “Moska do të mbysë Ukrainën”

Në qytet lufta nuk ka mbaruar kurrë: “Ajo urë që donte Putini ishte rënia jonë”. «Jeta civile e qytetit tonë është në gjumë dhe në rënie që nga viti 2014”



Kapanone të vjetërsuara, zyra të braktisura, rrugë të zbrazëta nga makinat dhe këmbësorët, e madje as hije kamionësh. Dhe ndërtesat pastaj të shkatërruara, dritare të thyera, makina të shkrumbuara e vagonë të ndalur në gjurmët e stacionit hekurudhor të portit si monumente të lashta në kujtim të një epike të largët të tregtisë dhe pasurisë, e cila duket e venitur përgjithmonë.

Por, për të karakterizuar rënien e portit të Mariupolit, që ishte flamurtari i pushtetit sovjetik, janë mbi dhjetra vinça gjigandë të viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë që ende qëndrojnë në kthetrat e acarit.

Deti që lag kalatat e shkretuara ndalon ngadalë të paktën në orën 15:00 të pasdites. Nuk ka anije për të thyer akullin dhe kryqëzori i vogël që merr në ujërat e zeza të baseneve të pafundme ka heshtur duke lënë një shirit të errët në mes të pllakave të ujit gri të ngrirë.

“Kjo është ajo që rusët duan. Fitorja e Putinit është “mbytja” e Mariupolit dhe porteve të tjera të Ukrainës me pamje nga Deti i Azov”

“Ata duan t’i vrasin ata dhe pastaj t’i

zotërojnë ata dhe të lëshojnë një goditje fatale për ekonominë e Ukrainës së lirë”, thotë ministri i Infrastrukturës, Vladimir Omelian, me të cilin u takova dje pasdite në mes të magazinave dhe vinçave. Nga këtu një javë më parë, tre anije (dy roje bregdetare dhe një ndihmëse) u nisën me 24 marinarë, që u ndaluan më pas nga plumbat e marinës ruse në Ngushticën Kerç, dhe pastaj u arrestuan duke ndezur tensione të reja midis Moskës dhe Kievit.

Mariupoli tregon shenjat e vështirësive të ngritura nga përpjekja e separatistëve pro-rusëve për ta kapur atë në kohën e sfidës për pellgun e Donetskut në verën e vitit 2014.

Për periudha të shkurtra, guerrillasit besnikë të Moskës të mbështetur nga skuadrat speciale të dërguara nga Putini arritën të pushtojnë një pjesë të qendrës. Përveçse atëherë u dëbuan nga përforcimet e organizuara nga qeveria e Kievit. Tani pikat e kontrollit që shënojnë pengesën e përparme janë një duzinë milje në lindje. Por linjat kryesore të komunikimit ndërpriten ose devijohen. Aeroporti

civil nuk funksionon. Treni deri në Kiev shkon për 18 orë. Dhe në rrugë është e nevojshme për të zigzaguar midis llogoreve të fushave të betejës në rajonet lindore dhe zonat e pushtuara nga rusët drejt gadishullit të Krimesë.

“Jeta civile e qytetit tonë është në gjumë dhe në rënie që nga viti 2014”.

Shumë nga bashkëqytetarët tanë kanë ikur në Odessa dhe Kiev për të mos u përfshirë në luftë. Në Mariupol arriti që rreth 100,000 njerëz të zhvendoseshin, pasi nuk donin të qëndronin me rusët në Donetsk.

“Situata është përkeqësuar në vitin e fundit me ndërtimin e urës së kërkuar nga Putini, e cila kombinon territorin rus me Krimenë përgjatë Ngushticës Kerç. Deti ynë Azov është duke u bërë rus. Kush prej rreth gjysmë milion banorëve tanë ka jetuar me aktivitetet e portit dhe anijet e saj janë zhdukur. Dhe ne po flasim për të paktën 10% të popullsisë”, shpjegojnë tre animatorë të qendrës kulturore në Mariupol, vendosur në një nëndetëse të vjetër, ndërtuar në kohë cariste.

Paraliza e portit nënkupton varfërinë dhe eksodin.

“Mariupoli kishte parë një rritje të fortë ekonomike pas rënies së perandorisë sovjetike më 1991. Prej këtu, rifilloi edhe eksporti i grurit tonë në Evropë, së bashku me qymyrin dhe çelikut. Por ura ruse ka bërë një goditje vdekjeprurëse. Porti në vitin e fundit sheh një rënie me mbi 30% të aktiviteteve. Kompanitë janë drejtuar në portin e Odessas, duke e lënë fatin e Mariupolit në duart e zotit”, thotë 35 vjeçari Alexey Orlov, punonjës i Arsenalit, një kompani e produkteve të teknologjisë së lartë dhe që ka parë rënien e qarkullimit për aktivitete në lidhje me trafikun e IT mbështetur te anijet.

Mbetemi të habitur kur komuniteti ndërkombëtar vazhdon të heshtë përballë vendimeve të Rusisë gjatë tre viteve të fundit për ndërtimin e “Urës së Krimesë”.

“Ne u përpoqëm të raportojmë. Por askush nuk na dëgjoi. Ura ruse përfaqëson një shkelje të të gjitha normave dhe traktateve ndërkombëtare. Duke filluar nga

lartësia, 35 metra, e cila pengon kalimin e anijeve të mëdha tregtare. Ne kishim kërkuar që ajo të jetë së paku 42 metra e lartë”, shpjegon zëvendësministri i mbrojtjes së Ukrainës, Anatolii Petrenko.

Kontrollet ruse për anijet që nisen për në Mariupol dhe Berdyansk, portin e dytë ukrainas në detin Azov, janë bërë edhe më intensive në ditët e fundit. Petrenko raporton se mbi 400 anije janë stacionare në Kerç.

“Në vitet 1930, demokracitë evropiane zvogëluan rrezikun e paraqitur nga Hitleri dhe pastaj u detyruan të përballëshin me një luftë të tmerrshme. Shpresojmë se tani ata e kuptojnë se ne ukrainasit luftojmë vetëm me një kërcënim që do të përfshijë së shpejti ose më vonë të gjithë BE-në”, thotë Ministri i Infrastrukturës.

Duke lënë zonën e portit në errësirë, ne takohemi me disa makina të ushtarëve të Ukrainës që shkojnë drejt vijës së frontit. I ftohti i ashpër nuk ndalon të nxehtin e konfrontimit me Moskën.

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LEVANTE - LUGO

1

TORINO - SUDTIROL

1

FEYENOORD - VVV VENLO

1

Sezon fantastik për Drenicën dhe Ymerin

Skuadra e Drenicës dhe portieri Arion Ymeri kanë pasur një sezon fantastik në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra kuqezi e mbylli kampionatin në pozitën e pestë, kurse Ymeri u rendit në mesin e katërt portierëve më të mirë. "Jam shumë i kënaqur me paraqitjet personale. Jam ndër katër portierët që kanë pësuar më pak gola dhe kur kësaj ia shtojmë faktin se ky është sezoni im i parë që jam titullar, më bën të ndihem mirë", ka thënë Ymeri

EPOKA E ENJTE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 DHJETOR - KF Drenica e ka mbyllur sezonin vjeshtor në pozitën e pestë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Portieri Arion Ymeri ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se rezultatet që i ka marrë skuadra kuqezi janë të merituar dhe se me pak fat ka mundur të jetë edhe në pozita më të larta. "E kemi një grup të lojtarëve shumë të mirë që kemi punuar me shumë seriozitet, për çka ka meritë të madhe trajneri Tahir Lushtaku, i cili në vazhdimësi na ka motivuar. "Paraqitjet në sezonin vjeshtor dhe rezultatet kanë qenë të këndshme dhe plotësisht të merituar. Me pak fat kemi mundur të kemi më shumë pikë dhe të jemi në pozitë më të lartë", ka thënë Ymeri.

Skuadra nga Skenderaj është paraqitur mirë në ndeshjen e Kupës, por në fund është mposhtur nga Prishtina me penallti. Lidhur me këtë ndeshje Ymeri ka deklaruar se lojtarët e Drenicës janë paraqitur mirë në një terren të vështirë për lojë, por fati ishte në anën e Prishtinës. "Synimi ynë është të bëjmë lojëra sa më të mira dhe të jemi sa më lart në tabelë. Në Kupë fati ishte që të takohemi me Prishtinën në rrethin e parë ku kemi bërë një lojë të mirë për 120 minuta për çka duhet të përgëzohen lojtarët që kanë dhënë gjithçka nga vetja në atë terren të vështirë për lojë, por në fund jemi eliminuar pasi në penallti fati ishte me Prishtinën", ka shtuar ai. Arion Ymeri është ndër portierët më të mirë në Superligë, pasi në 17 ndeshjet e zhvilluara ka pranuar 16 gola. Ai po vlerësohet edhe si ndër më meritoret për sukseset e skuadrës së Drenicës në



këtë kampionat. "Jam shumë i kënaqur me paraqitjet personale. Jam ndër katër portierët që kanë pësuar më pak gola dhe kur kësaj ia shtojmë faktin se ky është sezoni im i parë që jam titullar, më bën të ndihem mirë. Jam paraqitur në 17 ndeshje në kampionat dhe në një ndeshje në kupë. Dua ta falënderoj trajnerin e portierëve, Skënder Mustafën, për punën e

madhe që po bën, por edhe Tahir Lushtakun që gjithmonë u ka dhënë hapësirë lojtarëve të rinj. Unë nuk do të ndalem së punuari dhe me paraqitje të mirë do t'i shpërblej ata për besimin e dhënë", ka deklaruar Ymeri. Skuadra e Drenicës e mbylli sezonin vjeshtor në pozitën e pestë me 24 pikë, dy pikë më pak se skuadra e Gjilanit që është një pozitë më lart.

SHKURT

Tenisti shqiptar kualifikohet në kampionatin zviceran

Tenisti shqiptar Jasin Jakupi është kualifikuar në kampionatin e Zvicrës, në kategorinë U18, i cili nga data 11-13 janar 2019 do të mbahet në Kriens të Luzernit. "Me ndihmën e Zotit dhe tri lojërë të fituara, Jasini është kualifikuar për në kampionatin zviceran, ku marrin pjesë 20 lojtarë më të mirë në Kategorinë U18. Një sukses i veçantë pasi është kategoria më e vështirë që të kualifikohesh", ka thënë për "Albinfo.ch", Ahmet Jakupi, babai i Jasinit. Për momentin Jasini radhitet i dhjeti në kategorinë e U16, ku luajnë më shumë se 3 500 lojtarë.

Tmusiqi i bashkohet Prishtinës

Basketbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në basketboll, Mikalie Tmusiq, i është bashkangjitur skuadrës së Prishtinës pas një periudhe disamujore. Tmusiqi ka lindur më 6 janar 1993, kurse luan në pozitën dy dhe shquhet për presing dhe gjuajtjet për tri pikë.

E ardhmja e Robbenit, mes Holandës dhe Italisë

Arjen Robben ka konfirmuar se në fund të këtij sezoni do të largohet nga Bayern Muncheni. Menjëherë kanë filluar të qarkullojnë lajme lidhur me të ardhmen e yllit holandez. Interesim për të kanë shfaqur FC Groningen dhe PSV Eindhoven, por edhe në Itali janë të interesuar Milani, Napoli dhe Interi. Pavarësisht prej moshës, skuadrat italiane besojnë në përvojën e madhe që ka Robbeni.

Hasenhuttl, trajner i Southamptonit

Southamptoni e ka emëruar trajner të ri Ralph Hasenhuttl, i cili ishte trajner i skuadrës së Leipzigit në Gjermani. Rezultatet e dobëta gjatë këtij kampionati kanë bërë që drejtuesit e Southamptonit ta shkarkojnë Mark Hughes, kurse 51-vjeçari Hasenhuttl ka nënshkruar kontratë për dy vjet e gjysmë.

Berisha: Të rikthehemi te sukseesi ndaj Udineses

BERGAMO, 5 DHJETOR - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, ka luajtur nga minuta e parë në pesë ndeshjet e fundit me skuadrën e Atalantës, duke i dhënë fund politikës së trajnerit Gasperini për të bërë lëvizje herë pas

here. "Ne kemi një marrëdhënie shumë të mirë, si me Golinin, ashtu dhe me Rosin. Konkurrenca është si një stimul më shumë. Ne duhet të bëjmë mirë gjatë gjithë javës dhe në ndeshje vendos Gasperini se kush do të luajë.

Me Napolin nuk kishte shumë diferenca në fushë, por loja mori një rrjedhë tjetër. Milik godi nga një kënd i vështirë dhe një hap para i imi, bëri që ai të shënonte një gol të bukur. Në ndeshjen me Udinesen kemi mundësi të rikuperojmë

diçka dhe të rikthehemi te sukseesi, por edhe duke bërë një lojë të mirë. Ne duhet të marrim pikë ndaj një skuadre që është në vështirësi, pasi do të largohet nga vendet e ulëta ku ndodhet", ka thënë Berisha për "TuttoAtalanta".



Zeneli: Dua të luaja në një nivel më të lartë

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Arbër Zeneli është një nga lojtarët më të rëndësishëm të Herennvenit, ndërkohë që emri i tij është lidhur me disa

klube të tjera. Në Holandë e duan më të mirët, por ka interesim edhe në Itali dhe Turqi. Fenerbahçe është një nga klubet që e kërkon. "E

kam dëshmuar edhe këtë. Është një në ndeshje dhe një motivim për të marrë më të mirën nga vetja. Është mirë të jesh i rëndësishëm për klubin,

por të gjithë e dinë se cilat janë ambiciet e mia. Do të doja të luaja në një nivel më të lartë në fund të sezonit", ka thënë Zeneli.



Saviqeviqi: Do të kemi vështirësi në organizimin e ndeshjes me Kosovën

Podgoricë, 5 dhjetor - Kryetari i Federatës së Futbollit të Malit të Zi, Dejan Saviqeviq, ka thënë se e pret një sfidë të madhe në organizimin e ndeshjes me Kosovën në kualifikimet për "Euro 2020". "Ne si Federatë do ta kemi shumë të vështirë që ta organizojmë këtë ndeshje. Nga ana administrative është një grup që kërkon shumë angazhim. Mendoj se policia jonë kundër Serbisë ka treguar se di se si të organizojë një ngjarje të madhe, kështu që mendoj se edhe në lojën kundër Kosovës do ta bëjë punën e vet. Është edhe më e vështirë sesa një ndeshje me Serbinë sepse tani do të kemi: serbë, malazezë dhe shqiptarë", ka thënë Saviqeviq për mediet serbe. Në grup me Kosovën dhe Malin e Zi janë edhe Anglia, Republika Çeke dhe Bullgaria. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, kishte deklaruar se Kosova është një ndër dy përfaqësueset favorite të



grupit, por të njëjtin mendim nuk e ka Saviqeviqi. "Ky është mendimi i tij. Personalisht mendoj se është një deklaratë pak e ekzagjeruar, por tani ata janë në eufori të fitores në kuadër të Ligës së

Kombeve. Ajo që di unë, këto janë të gjitha paralajmëra. Ndoshta ka dashur në këtë formë t'i motivojë lojtarët, por terreni do të tregojë gjithçka", ka deklaruar Saviqeviqi.

Utah Jazz ia shton krizën San Antonios

SALT LAKE, 5 DHJETOR - Skuadra e San Antonios ka dështuar në përballjen ndaj Utah Jazzit, ku u mund 139-105, humbje që ka zbritur ekipin teksan në vendin e parafundit në Konferencën e Perëndimit. Shtatë lojtarë të Utah Jazzit realizuan mbi 10 pikë, me Mitchellin që ishte më i miri me 20 pikë. Një sezon zhgënjyes për Spursin, që duhej të ishte mes ekipeve pretendente, por bashkë me Houstonin mbylli renditjen në Perëndim. Zhgënjën edhe ekipi i Miamit, që u mund në fushën e vet 90-105 nga Orlando, ndeshje ku miqtë bënë diferencën në periudhën e fundit, falë 20 pikëve e 13 reboundeve të Gordonit. Jashtë fushës fiton edhe skuadra e Sacramentos, që mundi 122-105 Phoenixin, sfidë e komanduar gjatë gjithë kohës nga miqtë, që diktuan në fushë me lojën e tyre. Te Phoenixi mungoi lojtari lider, ndërsa për Sacramento u dalluan lojtarët e stolit, që realizuan 71 pikë (Hield, 20 pikë, më i miri). Fiton edhe ekipi i Indianas, që



mundi 96-90 Chicagon, ndeshje me shumë barazime, ku të dyja skuadrat dueluan fort deri në fund. Collison me 23 pikë ishte shënuesi më i mirë për Indianan, ndërsa 21 pikët e Markkanenit për Bulls-in mbetën për statistikë. Dallasi, falë 21 pikëve të Doncicit, mundi 111-102 Portlandin.

REZULTATET

Indiana - Chicago	96-90
Miami - Orlando	90-105
Dallas - Portland	111-102
Phoenix - Sacramento	105-122
Utah Jazz - San Antonio	139-105

SHKURT

Sharapova: Ja këshilla që më ka udhëhequr në suksesin tim

Në një intervistë të dhënë sot, tenistja ruse Maria Sharapova ka rrëfyer se cila ka qenë këshilla më e mirë që ka marrë në jetën e saj. "Këshilla më e mirë? Ajo që të rrethohem nga njerëz inteligjentë, duke bërë pyetje dhe duke mos i lënë asgjë rastësisë dhe të mendosh se gjërat janë të përfunduara", ka thënë Sharapova, ish-numri 1 në botë. "Kjo këshillë ka qenë e rëndësishme, sidomos në biznesin tim. Kemi një ekip të talentuar, që më ka ndihmuar shumë ta kuptoj rolin tim si drejtuese", u shpreh më tej Sharapova. Më tej, tenistja ruse i ka dhënë edhe një këshillë më të rinjve. "Gjithçka është e mundur që të arrihet nëse i përkushtohesh me pasion, dëshirë dhe dashuri. Rruga nuk është e njëjtë për të gjithë, ndaj mos ndiq kurrë rrugën që ka bërë tjetri para teje. Krijjo rrugën tënde dhe besoj se ajo", ka deklaruar Sharapova.

Icardi: Interi nuk ka frikë nga Juve

Ndeshjen e radhës Interi e zhvillon ndaj Juventusit. Kapiteni Mauro Icardi ka thënë se skuadra e Interi nuk ka frikë nga kampionët aktualë të Italisë. "Ndaj Juventusit nuk do të luajmë për barazim. Çdo sportist duhet të mendojë vetëm fitoren. Shkojmë pa frikë në Torino dhe të gatshëm ta luajmë këtë sfidë", ka thënë Icardi. Më 7 dhjetor në Torino nga ora 20:30 takohen Juventusit dhe Interi.

Pavardi në listën e Bayernit

Mbrojtësi francez Benjamin Pavard është në krye të listës së dëshirave të Bayern Munchenit. Sipas medieve gjermane, 22-vjeçari pritet të jetë përforcimi i radhës për 'bavarezët', të cilët këtë sezon duket se kanë shfaqur mjaft luhajtje, sidomos në repartin e mbrojtjes. Për këtë arsye, drejtuesit kanë rikthyer vëmendjen nga mbrojtësi i Stuttgartit, i cili ra në sy mbi të gjitha me paraqitjet e tij në Botëror, ku në fund u shpall fitues me kombëtaren e Francës. Por 'bavarezët' nuk janë klubi i vetëm që ndjekin Pavardin, pasi 22-vjeçari pëlqehet shumë edhe nga Napoli.

Fabinho kundër largimit nga Liverpooi

Mesfushori i Liverpooit, Fabinho, nuk është i interesuar të largohet nga Liverpooi për të kaluar gjatë janarit te Paris Saint-Germaini. "Më kanë thënë se ka pasur diçka në shtyp, por kurrë nuk kam thënë se do të doja të largohem nga Liverpooi. Unë e dija se do të më duhej ta pres momentin tim. Jam i lumtur në Liverpool. Nuk ka asnjë arsye që të largohem", ka thënë Fabinho.

Simeone: Griezmanni ose Varane e meritonin 'Topin e Artë'

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, e ka uruar Luka Modriqin për "Topin e Artë", por ka insistuar se Antoine Griezmann apo Raphael Varane është dashur të ishin fitues. "Të luash për Atletico-n e bën më të vështirë ta fitosh 'Topin e Artë' sesa kur luan për klubet e tjera sepse ne kemi histori pune, të bërjes së përpjekjeve të dyfishta për t'iu ofruar më shumë gjërave të rëndësishme. Siç e ka thënë edhe Griezmanni, ai është i lumtur për atë që ndodhi këtë vit. Ai është kampion bote, gjë që është shumë e vështirë. Të gjithë mund ta zgjedhin atë që mendojnë se është i duhuri. Ne e urojmë Modriqin. Ai pati sezon shumë të mirë. Për mua, më të mirë ishin Griezmanni dhe Varane", ka thënë Simeone.



EPOKA E RE		Autor: GAZMEND MORINA	VËLLIMI, MASA	VËMENDJE E KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIÇKA (shq.)	AI QË DEHET ME ETER	SHKRIMTARJA KAMBERI	MIRË DE, NË RREGULL	SHTET NË AFRIKË	ZANORE	LLOJ PJEPIRI VERDHE, I QULLËT E ME SHUMË LËNG, POR JO I SHIJSHËM	PËRHAPJA E VALËVE	BASHKËT.	EPOKA E RE
		AKTORJA ANGLEZE NË FOTO											JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM
		MJET PËR PËRÇIMIN E VALËVE (shq.)							ALYSSA MILANO			BASHKËT. ORGANI I RIPRODHIMIT TË BIMËVE	
		SHTERPË QYTET NË SHQIPËRI							KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE TENISTI SAFIN				
							AXHAMI, KALAMA AGIM TEJECI						
		ERA E KËNDSHME							KOMPOZITORI KOCI (shq.) PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE				
		LETRARI ZYKO KAMBERI		QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; E KUJDESSHME DILETANTET						AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (shqip.) KËPUÇE PËR RRËSHQITJE MBI AKULL			
							DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS HISTORIANJA KEÇMEZI BASHA					OHIO ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY	
EPOKA E RE	QË BËHET NDERMJET TRI PALEVE	BARAZIM NË SHAH	PUNËTOR QË PASTRONTE E RREGULLONTE DHOMAT NË HANE (vjet.)	3.14 (mat.)	ZANORE	SHTET FEDERAL NË SHBA LETRARI XOXA						DY BASHKËTINGËLLORE KAMPIONI	
	QYTET NË SHQIPËRI						ISLANDA KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE		ANTON PASHKU KUNDREJT E VJETËR		RAST FILMI I PARË SHQIP		MUZIKOLOGU SHQIPTAR SOKOLI
	ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR JUPI					PËREMËR VETOR DY BASHKËTINGËLLORE		E MBARUAR, E PËRFUNDUAR ZANORE					
	KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON		TRAJNERI BRAZILIAN LUIZ FELIPE SHKRITËTIRA MË E THATË NË BOTË							SHPIRTI (Lat.) SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE			
	FILOZOF NË GREQINË E LASHTË						PRINCESHA RUMUNE GJIKA EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN					ARIAN MALIQI SHTET NË AZI	
	QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE					DAMARI I GJAKUT REKUJZITË SPORTIVE (shq.)			FRYMA KOHË BRENDË SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË			KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA DY BASHKËTINGËLLORE	
	VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA (sh.shq.)					KËNGËTARJA TARNER SHINË E TRENIT			ZANORE ERNEST KOLIQI		ROBERT REDFORD		BASHKËT. SHENJA MUZIKORE
	SHKRONJA VIII & XVIII		HATA FARISHTË				DËSHMORI PEÇI VIJË A RREMB UJI QË KALON NËN TOKË				SHTET NË AFRIKË TËPSI PREJ BALTE (sh.shq.)		
	BASHKËT.		I VRULLSHËM SHAPKA				MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI (pashq.)					TRUP GJEOMETRIK MJET SI KAMBANË FARE E VOGËL (sh.shq.)	
EPOKA E RE	FURRË KU PIQEN TULLA (sh.shq.) ATDHE							BASHKËT. KAJDE, OJNA (sh.shq.)		LËNG QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS DHELPËRI (sh.shq.)			ISH FUTBOLLISTI YNË SHAQIRI
	PATRIOTI PASHKO					"ASHTU QOFTË" TOKË E BUKËS (sh.shq.)			FUTBOLLISTI SPANJOL MARTINEZ (shqip.)			SHKRONJA TË NJËJTA POETI RAÇI	
	VËLLAI I MADH		LLOJ KARROCE KUAJSH NJËSI KOHE						ZANORE GAZETARJA SHIPTARE ... TIÇO		EMRI I PASHAIT TË JANINËS		SHKRONJA XXIV SHOUMENI KRASTA
	MUAJ I VITIT					NJERI I PACIPË E I PAFYTYRË, NJERI I POSHTËR MARK ANTONI					OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) NJË NGJYRË		
	ATALANTA, LIVORNO		KORNIZË BASHKËT.				FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS BASHKËT.					ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGAM BASHKËT.	
	ANIJATË; PJESE E BRENDSHME E NJË KISHE (sh.shq.)						FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE					VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite - Ministry of Labour and Social Welfare

FTESË PUBLIKE

PËR

APLIKIM NË KËSHILLIN EKONOMIKO -SOCIAL (KES)

Në përputhje me nenin 7, paragrafi 4, të Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social (KES),

Me qëllim të promovimit të dialogut social në nivel nacional dhe krijimit të politikave të mirëfillta sociale dhe ekonomike si dhe në dobi të partnerëve social, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shpall:

FTESË PUBLIKE

Të gjitha organizatat e të punësuarve (sindikatave) dhe organizatat e punëdhënësve, ftohen që të aplikojnë për t'u përfaqësuar në Këshillin Ekonomiko-Social të Republikës së Kosovës.

Për të aplikuar për përfaqësim në Këshillin Ekonomiko-Social, organizatat e të punësuarëve (sindikatat) dhe organizatat e punëdhënësve, duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Organizatat e të punësuarve (sindikatat) duhet të paraqesin këto të dhëna:

- numrin e përgjithshëm të anëtarëve, të vërtetuar përmes dëshmisë (deklaratave personale, librezës së anëtarësisë etj) dhe pagesës së anëtarësisë sindikale, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në Republikën e Kosovës;
- numrin e marrëveshjeve kolektive të lidhura me ndërmarrjet apo institucionet e ndryshme;
- numrin e degëve sindikale, të anëtarësuar në format e organizimit sindikal në nivel nacional, të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES;
- numrin e zgjidhjeve të kontesteve të punës dhe kontesteve tjera përmes marrëveshjeve kolektive dhe të ndërmjetësimit;
- anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të punëtorëve.

2. Organizatat e Punëdhënësve duhet të paraqesin këto të dhëna:

- numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve të anëtarësuar, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Administratën Tatimore të Republikës së Kosovës;
- numrin e punëtorëve të punësuar në ndërmarrjet e anëtarësuar, në organizatat e punëdhënësve të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES;
- numrin e zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve tjera, përmes marrëveshjeve kolektive dhe ndërmjetësimit;
- numrin e ndërmarrjeve dhe subjekteve tjera ekonomike të cilat drejt për së drejti ndikojnë në nxitjen e punësimit dhe zbutjen e papunësisë;
- anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve

Aplikacionet për përfaqësim në Këshillin Ekonomiko-Social dhe dokumentacioni me të dhëna të sakta duhet të dërgohen më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas publikimit të ftesës në mediat e shkruara e elektronike dhe në ueb-faqen e MPMS-së.

Aplikacionet duhet të dërgohen personalisht nga ndonjëri përfaqësues ligjor i organizatës së punëmarrësit apo punëdhënësit në Sekretariatit Koordinues të Këshillit Ekonomiko-Social, i cili gjendet në ndërtesën e Inspektoratit të Punës, përballë Restaurant "Pishat", Rr. Qamil Hoxha nr.30, Prishtinë.

Informatat e tjera plotësuese mund të merren çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrin e telefonit: 038-213- 989 ose në e-mail adresën fatime.avdyli@rks-gov.net;



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA – REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT MUNICIPALITY OF JUNIK – OPŠTINA JUNIK

Kuvendi Komunal
02/01/18
Datë:06.12.2018
Junik

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 8, paragrafi. 1 përzgjedhjen e anëtarëve në komitetin konsultativ Kuvendi i komunës shpall konkurs publik:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Kuvendi komunal në Junik
Titulli i vendit të punës: Anëtarë i komitetit konsultativ

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtarit e ndryshme në pajtim me statutin e komunës;
- Dhënie e propozimeve për rregullore të ndryshme;
- Hulumtime të ndryshme;
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i komunës, komitetet e përhershme apo kuvendi i komunës në fushën përkatëse;
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës;
- Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare e dëshirueshme, e obliguar diploma e shkollës së mesme.

Aftësi / përvoja dhetribute tjera që kërkohen: Të ketë aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhimin e punëve, shkathësi kompjuterike, (Word, Excel).

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejte aplikimi kane të gjithë banoret e komunës së Junikut, të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkohet për pozitën përkatëse.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: Zyrës së Kryetarit të Komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga data e publikimit nga data: 06.12.2018.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar të komunës së Junikut.

Aplikacionit i bashkëngjitet: Kopja e diplomës mbi kualifikimin, Kopja e Letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, Ekstraktin e lindjes.

Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushte për interviste njoftohen: Ueb faqen e komunës, njoftimin publik në telefon në afat ligjor për procedurat e intervistimit.

Kuvendi i Komunës së Junikut:

Muharrem KRASNQI

C.nr.338/18

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Liridon Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Faik Selmani nga fshati Druar, Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditueses Kathrin Rachow nga Gjermania, tani me adresë të pa njohur, për shkak të shkurorëzimit, më datën 05.12.2018, merr këtë:

A K T V E N D I M

- CAKTOHET** përfaqësues i përkohshëm avokati Kamer Caka nga Vushtrria, për të ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrat për të padituesen Kathrin Rachow, derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë.
- Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarr të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të paditueses, deri në momentin kur e paditura të paraqitet personalisht në gjykatë, të caktoj të autorizuarin e saj, apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë-Qendra për Punë Sociale në Vushtrri, ti caktoj kujdestarin.
- SEANCA** e radhës caktohet me datën 27/12/2018, në ora 10:00 dhe ky komunikim palëve ju shërben në vend të thirrjes së rregullt.
- Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala paditëse.
- Ky aktvendim do të publikohet në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljes të kësaj Gjykate, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të paditueses, paditësit dhe Organit të Kujdestarisë.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI,

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.338/18 e datës 05.12.2018

GJYQTARI
Liridon Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar të drejta në ankesë.




**DOLI NË SHITJE
LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ,
"VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE
NË SHTETET E BALLKANIT"**

Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe

- veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse në Ballkan.
- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333